



SUPLEMENTI "THASH&THEM"

► Faqe 13-20

- **JA ARTISTËT QË MBËSHTESIN BAMIR TOPIN**  
Aktiviteti në Shkodër, me figurat e njohura të skenës
- **AT'NIKOLLA: PSE E REFUZOVA REVISTËN ELLE**  
Stilistja tregon prapaskenat e krijimit dhe frymëzimit



**Senatoria italiane Bonino: Shqipëria të mos e humbasë Europën**

► Faqe 7

# [SHQIPTARJA.com]

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi "THASH&THEM"

VITI II - NR. 267 E shtunë, 10-11-2012

TELEVISIONI MË I RI INFORMATIV NË SHQIPËRI

A1 REPORT!

origina e lajmit...

## INTERVISTA

# Ish-koordinatori i grevës së urisë rrëfen telefonatat tek çadra e grevës **ASLLAN PATRIOTI: PRESIONET MBYLLEN GREVEN E URISË**

Sinjalet për shpërndarjen e grevistëve. Biseda me njeriun e qeverisë në qeli. Arrestimi për rryshfetin 700 euro: Italiani Massimo Nicolini insistoi që të më paguante për gjetjen e makinës

### Lajmi

Asllan Patrioti, ish-koordinatori i grevës së urisë të ish-të dënuarve politikë tregoi dje për herë të parë bisedën me italianin Massimiliano Nicolini për grabitjen e makinës dhe insistentimin e tij që ta shpërblente me një "kafe" për ndihmën që i kishte dhënë.



Në foto: Asllan Patrioti, ish-koordinatori i grevës së urisë të ish-të dënuarve politikë

■ ■ ■ TIRANE

ANXHELA TATO

Italiani Massimiliano Nicolini insistoi që të më jepte 700 euro, për nderin që i kisha bërë, duke e ndihmuar që t'i kthehej makina që i ishte vjedhur". Vetëm një ditë pas lirimit nga gjykata, ish-koordinatori i grevës së të përndjekurve politikë, Asllan Patrioti tregon për "Shqiptarja.com" të...

► vijon në faqe 4-5

## INTERVISTA E SOCIALISTIT

# Ruçi: Fitojmë pa LSI-në, FRD e AK, Malaj të heshtë

"Aleancat, në 2011 morën më shumë vota se në 2007"



■ ■ ■ TIRANE

ALFRED PEZA

Kreu i Asamblesë dhe i grupit të PS Ruçi tha se zgjedhjet PS do ti fitojë dhe pa LSI, ndërkohë që tha se FRD e...

► Faqe 6

**NERANXI**  
... gjithmonë një hap përpara...  
**Shurupë për kokteile dhe likerëra për bare dhe restorante**  
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 7, Yrëhak Tiranë. Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com

REAGIMET

► Faqe 9

**Vdekja e 11-vjeçarit, mjeku irlandez qan: Na falni**

FRIKA

► Faqe 10

**Amnistia, grekët: Do na vijnë kriminelët shqiptarë**

BOJKOTIMI

► Faqe 6



**Ceremonia e KiE, s'vijnë 18 presidentë e 47 ministra**

AKTORI

► Faqe 2-3

**Remo Girone: Ndryshoj nga "Katani", u martua 25 herë**

### Refleksion



NGA SHPËTIM GJIKA

**Historia, është mësuese e jetës**

Profesori i nderuar Arben Puto, na dha një rast të gjithëve në këtë vit jubilar të 100 vjetorit të parë të Shqipërisë zyrtare për të reflektuar seriozisht mbi të vërteta historike me vlera të padyshimta, të palëkundura e të palëkundshme. Të vërteta të cilat qëndrojnë pikërisht në themelet e asaj veprë madhështore, të... ► vijon në faqe 22

### Koment



NGA GENCI KOJDHELI

**Ushtria e NATO e ushtria e natës**

Qysh prej tranzicionit të Shqipërisë drejt demokracisë rreth 20 vite më parë, pak a shumë të gjithë sektorët e qeverisjes janë bërë objekt i zhbirimit mediatik, interesit publik, debateve parlamentare, parashtrimit të fakteve, prezantimit të analizave, spekulimeve, akuzave të qëna e të paqëna politike, pra... ► vijon në faqe 22



# Intervista

**MASSIMILIANO:** Zoti Asllan nëse Jaguari gjendet do ta shesh dhe gjysmën e lekëve do t'ia dhuroj shoqatës suaj, ndërsa ty nga dëshira për ndihmën do të të jap një kafe.

**ASLLAN PATRIOTI:** Italiani nxjerr 100 euro dhe kur mi jep më thotë se kishte mamanë me kancer. Për keqardhje refuzoj që ti marr, por ai insiston dhe më thotë se do më jepte edhe 600 euro të tjera

# Asllan Patrioti: Policia më ngriti kurth për eurot

## Rrëfimi i ish-kordinatorit të grevës, e vërteta e makinës

■ ■ ■ **TIRANE**  
**ANXHELA TATO**

vijon nga faqja 1

...vërtetën e njohjes me shtetasin italian, biseda për grabitjen e makinës dhe dëshira e tij për të shpërblyer për ndihmën e dhënë. Patrioti tregon se vetë Massimiliano i kërkoi ndihmë për gjetjen e automjetit, ndërsa i premtoi se do ta shpërblente duke i dhuruar shoqatës gjysmën e lekëve nga shitja e Jaguarit.

**-Si e keni njohur shtetasin italian Massimiliano Nicolini?**

Me Massimilianon jemi njohur në një panair pune në Durrës ku kërkua që tek firma e tij të punësohej një vajzë që quhej Jonida. Ajo fitoi pikët e testit dhe u punësua. Objekti i punës ishte që punonjësi të afronte sa më shumë klientë, pasi përfitonte pikë shtesë në pagë. Italiani ka një kompani që ofron sigurime financiare e shëndetësore për spitalet private. Ne për të ndihmuar Jonidën që të merrte më shumë pikë, i ofruam kategorinë e të përndjekurve politikë. Kjo shtesë ka nevojë për siguracione shëndetësore dhe nuk ka mundësi financiare. Jonida e diskutoi me italianin për të bërë një marrëveshje dhe ramë dakord.

**-Kur e morrët vesh se Massimiliano i kishin grabitur makinën?**

Ditën që u bë oferta, mua më bëri përshtypje që Massimiliano erdhi pa makinë. I them Jonidës si kishte mundësi që ai vinte në këmbë meqë ishte biznesmen. Italiani i thotë Jonidës në këto momente: Kam nevojë të bisedoj me Asllanin se është njeri me autoritet. Pasi nënshkruam marrëveshjen u ulëm në restorant, ku na ofroi një drekë të vogël. Massimiliano më thotë: "Kam qejf të të tregoj diçka". Nxjerr Laptopin dhe aty më tregon një foto të makinës "Jaguar", ku dukej një person tjetër që po hapte derën e makinës.



Asllan Patrioti duke dalë nga Gjykata

### Biseda

Massimiliano më thotë: "Kam qejf të të tregoj diçka". Nxjerr Laptopin dhe aty më tregon një foto të makinës "Jaguar", ku dukej një person tjetër që po hapte derën e makinës.

thotë: "Po kam bërë denoncim në Durrës dhe është transferuar tek komisarati nr.4 i Tiranës". I them: "Dëgjo, atje kam një shok që është i punësuar dhe ne shkojmë nesër dhe e diskutojmë me ta". Shkojmë të nesërmen dhe takoj shokun tim, i cili e njihje problemin e Massimilianos. Më thotë: "Asllan e njoh problemin dhe ky italian i ka bashkëjetuar me menaxheren e tij, e cila ishte e fejuara e tij. Ajo pretendon se ka pjesën e saj në biznesin e italianit dhe se çdo gjë e kanë bashkë".

**-Cili ishte roli juaj për të ndihmuar Massimilianon?**

Meqë Massimiliano ishte shumë i mërzitur, unë ndërhyra te shoku im dhe i kërkoi si ndër që të përshpejtohej procedura për gjetjen e makinës. Zotëria mafioz dhe pa karakter nga mërziçja dhe lodhja për makinën shprehet në një bisedë tavoline me këto fjalë: "Zoti Asllan nëse "Jaguar" gjendet do ta shesh dhe gjysmën e lekëve do t'ia dhuroj shoqatës suaj, ndërsa ty nga dëshira për ndihmën do të të jap një kafe". Makina u gjet në korrik dhe më njoftuan se ndodhej në komisarati. Urgjent unë njoftoj Massimilianon dhe i them: "Hajde se është gjetur makina dhe merre te komisarati". Massimiliano nis të nesërmen në Tiranë në komisarati. Sipas rregullave dhe ligjit ishte bërë vërtetimi i pronësisë së makinës. Shefi i thotë se nuk mund ta merrte, pasi duhet të lëshonte një autorizim prokurori. Massimiliano më njofton mua në celular dhe më thotë: "Asllan hajde

### Gruaja

## "Jam e lumtur që Asllani erdhi në shtëpi"

E gëzuar dhe e përlotur bashkëshortja e Asllan Patriotit shpreh lumturinë për lirin e tij. "Jam e lumtur dhe tani që ai do të vi në shtëpi, ndjehem shumë më mirë. Sic çdo femër nuk ndjehesa mirë që ai ishte në qeli", shprehet Silvia Patrioti. Ndërsa në zërin e saj kuptohet lumturia për lirin e ish-kordinatorit të grevës. E pyetur për këtë vendim të gjykatës Silvia thotë se bashkëshorti i saj është i pafajshëm dhe akuzat e ashtë e reme. Më tej vijon duke thënë se Asllani ka luftuar dhe ka kontribuar



Silvia Patrioti

për demokracinë. "Burri im është i pafajshëm për këtë akuzë. Ai ka kontribuar dhe ka luftuar për demokracinë dhe akuzat e ashtë e reme, është politike".

kishin grabitur. Ai më tha: "Asllan kam pasur një kompani në Vlorë dhe kisha një menaxher, së cilës i lija çdo gjë në kontroll. Kur u sëmura me ngatërrim zorrë më nisën me urgjencë në Itali. Ndenja disa muaj i shtruar dhe kontaktoja në celular me

menaxheren e firmës. E pyesja sesi ishte gjendja dhe ajo më thoshte se çdo gjë ishte në rregull. Kur erdha në Shqipëri ajo kishte vjedhur 50.000 euro dhe dy makinat të llojit "Hummer" dhe "Jaguar". Unë e pyes: A ke bërë denoncim në polici. Më

pak në Tiranë se miku jot nuk po më jep makinën". Unë nisën nga Durrësi dhe çdo shpenzim është bërë nga xhepi im për ato 6 herë që ikja dhe vija. Shkoj në Tiranë dhe takoj mikun tim, i cili më thotë se ma kishte plotësuar dëshirën për gjetjen sa më shpejt të makinës. Ai më sqaroi se automjeti nuk mund të merrej pa autorizim të prokurorisë. Nisem bashkë me një polic gjyqësor për të takuar prokurorin, i cili ishte me leje dhe vinte pas 10 ditësh. Massimiliano pas 10 ditësh merr makinën dhe nuk më bën asnjë telefonatë për të më falenderuar për ndihmën.

**-Çfarë ndodhi ditën e arrestimit tuaj?**

**Me Massimilianon jemi njohur në një panair pune në Durrës ku kërkua që tek firma e tij të punësohej një vajzë që quhej Jonida".**

Pas 2 muajsh Massimiliano më bën një sms, ku shkruhej se donte të pinte një kafe me mua për nderin që i kisha bërë. Unë nuk dija italisht dhe vajta tek Jonida që të më përkthente sms-në. I kthej përgjigjen Massimilianos dhe i them se isha në Tiranë tek greva e të përndjekurve dhe se mund ta takoja kur të donte. E lamë që të takoheshim të nesërmen në ora 12:00 tek një kafe në kat të tretë përballë Vilës Gold. Pimë kafe atë ditë

**I them: Skënder po iki për intervistë. Ai do më njoftonte nëse do më ndiqnin nga pas. Kur u nisa ishin 5 makina të SHKB-së dhe tek zona e Ali Demit vendosa që të hipja në një makinë tjetër.**

dhe Massimiliano më pyet sesa doja për nderin. I them: Nuk dua që të diskutojmë dhe sa ke ndërmend me jep, nuk është problem. Gjithnjë duke qenë brenda rregullave meqë



Në foto: Ish-grevisti i urisë Lavdosha Beqo duke i dhënë dorën njerit prej policëve tek çadra e grevës

ishte vullneti i tij. Italiani nxjerr 100 euro dhe kur mi jep më thotë se kishte mamanë me kancer. Për keqardhje refuzoj që ti marr, por ai insiston dhe më thotë se do më jepte edhe 600 euro të tjera pasdite në orës 17:00. Masdite unë isha për një intervistë tek A1 Report. Pas emisionit shkoj tek e njëjta kafe, por nuk e gjeta aty. Pres gjysmë ore dhe kur zbres tek makina, ky vjen dhe ulemi tek një kafe në kat të dytë. Në bisedë e sipër më thotë pse nuk ishin edhe miqtë e mi se donte ti jepte nga një kafe edhe atyre. Unë i them se ata e dinin që ky ishte një manjak pas përgjimeve të bisedave. Ky nxjerr 600 euro nga xhepi dhe mi jep. U takuam, u përfaqëuam dhe hipi në makinë për të vajtur tek greva. Në orën 21:00 isha ftuar tek Neës 24 për një intervistë dhe lekët i kisha me vete në xhep. Kur po hanim bukë me Skënderin pamë që kishte shumë lëvisje. Të dy i themi njëri-tjetrit se kishte diçka jo në rregull dhe do merrnin ose mua ose atë. I them: Skënder po iki për intervistë. Ai do më njoftonte nëse do më ndiqnin nga pas. Kur u nisa ishin 5 makina të SHKB-së dhe tek zona e Ali Demit vendosa që të hipja në një makinë tjetër. Në këto momente 20 veta vijnë dhe më arrestojnë. Në fillim më akuzojnë për mitingun dhe më pas ndërrohet akuzat. Nuk më shkante mendja në asnjë moment për lekët që i kisha me vete. Akuzat ishin të korupsionit pasiv, dhe nuk më përshatej mua pasi s'jam anëtar i kabinetit të Kryeministrit. Ato 700 euro u bënë sikur të ishin 700 milionë lekë të korupsionit Meta-Prifti që dolën më pas si të pafajshëm.



## Valteri: Terrori më i madh se në burg



Besim Valteri pas mbylljes së grevës ka thënë se terrori ishte më i madh se në burg. "Nuk mund ta shtyjmë më tepër, i thonë 31 ditë dhe prej të 20 ditë nën terror psikologjik, sa ministri i punëve të Brendshme ia kalonte Kadri Azbiut. Në burgun e Burrelit të paktën na linin ujën me sheqer, këtu na morën dhe çajin", deklaroi Besim Valteri

## "Mbyllja e grevës për shkaqe shëndetësore"



Guxim Kullolli, një tjetër grevist që ndodhej në çadër prej thaujae një muaji, shprehet se arsyet e ndërprerjes së grevës lidhen me situatën e rënduar shëndetësore, ndërsa pohon se protesta e tyre do të vazhdojë, por në mënyrë paqësore. "Arsyet se përse na vendosëm të ndërprisim grevën lidhen vetëm me arsye shëndetësore.



### REFIMI I ISH-KOORDINATORIT

# "Presioni me telefon mbylli grevën e urisë"

## Zhënjimi i drejtuesit të grevës që u shpërnda

■ ■ ■ TIRANE  
ANXHELA TATO

Asllan Patrioti tregon se ka marrë sinjale se greva do të prishej dhe do të mbyllej. Ish-kordinatori tregon se bashkë me Skënder Tufën u vunë në dijeni për fatin e grevës. Ndërsa tregon se do të kishte dashur që ky vendim të ishte marrë me shumicë nga grevistët pjesëmarrës. Por siç thotë telefonatat e dhanë efektin e tyre duke i vënë vulën grevës. Asllan Patrioti tregon se i ka shkruar një person i veçantë për vizitë në qeli duke e pyetur nëse ishte i kënaqur nga kjo që ndodhi. Përgjigjia e Patriotit ishte se qenë me fat që nuk pati më viktimë, ndërsa për fatin e grevës personi i veçantë nga instancat e lartë ishte në dijeni.



Asllan Patrioti

### Takimi

Asllan Patrioti rrefen takimin në qeli me një person të veçantë nga instanca të larta qeveritare, i cili e pyeti nëse ishte i kënaqur me grevën.

bëri. Nuk dua më të merrem me të dhe për kontratën që kam lidhur me të do të ngre padi penale. Kompania e Massimilianos është jo reale dhe sigurancionet që plotësoheshin ishin fleta boshe pa vlerë.

### -Çfarë mund të më thoni për vendimin e qeverisë pr kështin e dytë?

Ne nuk jemi dakord për kështin e dytë, na takon që të marrim çdo vit kështin dhe shiteti duhet të plotësojë edhe 3 këste të tjera. Nëse Kryeministri do të tallet me këtë shtresë që e ka mbajtur 22 vjet e qeveri duke na ka bërë plehrë të komunizmit dhe njerëz pa dinjitet, bën një faj të madh. Nëse ju doni që të mos ndëshkoheni merrni mundimin, kthejini sytë nga kjo shtresë e vuajtur e shtakërruar nga të gjitha anët. Mendoj se edhe në bazën e Durrësit Kryeministri duhet të ndërhyjë duke strukturuar këtë shtresë. Shkaku pse humbën zgjedhjen është mungesa e komunikimit me këtë shtresë në Durrës.

### -Si e pritët vendimin e Gjykatës së Apelit?

Arrestimi im ishte politik dhe jo në emër të korrupsionit pasiv. Nuk jam dakord me akuzën e ngritur ndaj meje. Gjyqi në shkallë të parë u bë me detyrë të mbyllura duke nxjerrë jashtë familjen time dhe median. Gjyqtarja që gjykoj çështjen time dhe edhe vendimin e shpërndarjes së grevës. Ajo pa turp nuk hoqi dorë por vazhdoi gjykimin, edhe pse avokati im i kërkoi dorëheqjen. Vendimin e Apelit nuk e prisja dhe jam i pafajshëm. Ky është një dënim politik, është komplet.

### Kësti i dytë

## Gjergj Ndreca: Nuk pranojmë lëmshë, po na përdorin për statusin

■ ■ ■ TIRANE

Pas vendimit të qeverisë për të dëmspërblyer disa nga grevistët që u ngujuan në çadër e urisë për një muaj me radhë, ka reaguar Gjergj Ndreca. Sipas tij, lëmshja e qeverisë, nuk mund të mbulojë flakët e Lirak Bejkos. Ndreca ka deklaruar se protesta e tyre do të vazhdojë dhe se qeveria bën mirë të respektojë ligjin, duke u dhënë tre këste të dëmspërblyer. Ndreca shkon edhe më tej kur deklaron se qeveria po i përdor ish të përndjekurit për t'u futur në BE. "Janë sensibilizuar të gjithë, që nga përfaqësuesit diplomatike, OSBE, BE, ambasadori amerikan në Tiranë dhe vetë Filip Reeker në Amerikë. Nuk do të lejojmë të na hedhin hi syve. Flakëve të Lirak Bejkos, vetë flijimi i asaj greve, ku të burgosurit politikë e paguan edhe me jetë, nuk mund t'u vihet kapaku me një këst që jep qeveria. Tashmë çështja jonë është ndërkombëtarizuar dhe qeveria po e përdor çështjen tonë për t'u futur në BE. Por ne nuk digjemi dhe masakrohemi për të çuar komunistët në Evropë, si hajdutë, si vrasarët e kombit. Ne



Gjergj Ndreca

ishim më të plaçkiturit në atë kohë dhe jemi më të plaçkiturit në këtë kohë. Na kanë shkelur me këmbë. Sa të marr frymë, nuk mund të harrojmë flakët e trupit të Lirak Bejkos që u dogj si Xhordano Bruno në Shqipëri në 2012. Ne nuk do të ndalemi me kaq. Ne do të vazhdojmë protestat deri në fund, por jo duke komunikuar me këta kriminelë e me këta njerëz obskurantistë. Me paturpësinë më të madhe Kryetarja e Kuvendit, ajo kryetarja e obskurantizmit popullor, nuk bënëgjis të kohet në këmbë, për një njeri, i cili u dogj si qiri në mes të Evropës. Gjergj Ndreca, fukara ishte dhe mbeti, ndërsa Lirak Bejko e lau me jetën. Atë që kemi pësuar ne, e pësofshin më keq dhe ku ju dhimbset më tepër këta", na thotë Gjergj Ndreca.

### -Si e morët vesh lajmin e vdekjes së Lirakut?

Isha në qeli dhe në kishim televizor. Dëgjoja se kishte vdekur Liraku dhe u trishtova shumë. Nuk e prisja vdekjen e tij po për mua dhe shokët e mi bashkëvuajtës Liraku do të njihet gjithmonë si një hero i demokracisë dhe të përndjekurve politikë. Desha të ngushëlloj familjen dhe me keqardhje nuk mora dot pjesë në ceremoni, pasi isha në qeli. Ngushëllimet e mia dhe të familjes për familjen Bejko. Së shpejti do të mblidhemi që për familjen Beko të caktohet një pension mujor, dot ose jo Kryeministri. Kërkoja që të merrja pjesë në ceremoni, por prokurori nuk më dha leje, meqë isha person nën hetim. Shoku ynë vdiq me barkun bosh, pa punë, pa shtëpi, pa strehë. La 2 vajza dhe gruan në mes të katër rrugëve.

### -Si e pritët vendimin e mbylljes së grevës?

Bëra mirë që më ngacmove për këtë pikë. Dua të them se bashkë me Skënder Tufën morëm sinjale më përpara se greva do të prishej. Vetë greva e urisë ishte shumë e pastër, por do të kisha dashur që mbyl-

### Skënder Tufa

## "Greva e arriti qëllimin, grevistët të lodhur"

Me datë 22 tetor Skënder Tufa bën me dije lajmin e mbylljes së grevës. Në një prononcim për mediat Tufa u shpreh se grevistët ishin të kënaqur që çështja e tyre u ndërkombëtarizua, duke pasur reagime nga OBE-ja e deri tek SHBA. Ndërkohë që një tjetër arsye, e cila i ka shtyrë grevistët të marrin këtë vendim, duket se ka qenë edhe fakti që ata e dinin shumë mirë se kryeministri Berisha, nën presion, nuk do të ndërmerre asnjë nisim për dëmspërblym. Gjithashtu, një tjetër arsye se përse ven-



dosën të linin grevën është edhe fakti se ata treqonin të përçaheshin. Duke qenë se kishin ngelur vetëm 6 persona dhe shëndeti i tyre sa vinte e përkeqësohej, si domos pas heqjes së lëngjeve dhe sheqerit.

llja e grevës të ishte bërë me vendimin e shumicës. Por telefonatat ndërhyrës bënë punën e vet. Madje sot kam takuar një grevist, i cili ndanë të njëjtin mendim me mua se ndikimi i telefonatave e mbylli grevën. Gjatë kohës që isha në qeli më vjen një person i veçantë, i ngarkuar për të më takuar mua. Ai më thotë: Je i kënaqur me kaq sa ndodhi. I them: Kënaqësia ime

është vetëm për një moment që nuk ka më viktimë. Më pas i them personit të veçantë që vinte nga instanca të larta: "Ju e dini më mirë se unë për prishjen e grevës".

### -Po me Massimilianon keni pasur më kontakte?

Nuk kam folur më me Massimilianon pas arrestimit. Por sipas fjalëve që më kanë thënë, ai është penduar për çka më



### Meta: Statusi në BE, bashkëpunim i palëve është i domosdoshëm

Kryetari i LSI Ilir Meta, ka zhvilluar dje takime me anëtarët dhe simpatizantët e LSI në Qarkun e Dibrës, konkretisht rrethet Mat dhe Bulqizë. Meta i ka bërë dhe një herë thirrje politikës shqiptare që të bashkëpunojë për përbushjen e detyrimeve për avancimin e procesit të integrimit evropian të vendit. Sipas tij për të marrë statusin e vendit kandidat është i

domosdoshëm bashkëpunimi i palëve. Duke bërë thirrje që së bashku me qytetarët klasa politike shqiptare të punojë me përgjegjshmëri për të ecur më shpejt drejt BE, lideri i LSI tha që interesi i vendit duhet të jetë prioriteti kryesor i të gjithëve. Për të dhjetori është një muaj kritik për Shqipërinë. Kjo sepse sipas tij pritet normalisht të merret një vendim nga vendet anëtare të BE-së për dhënien

ose jo të statusit të vendit kandidat. "Prandaj jepen mesazhe bashkëpunimi për të mirën e Shqipërisë. Zgjedhjet janë tepër të rëndësishme, sepse, pavarësisht se duhet të merret statusi, duhet të plotësohen tre rekomandimet, përsëri bërija e zgjedhjeve sipas standardeve do jenë shumë të rëndësishme për hapjen e negociatave, për vazhdimin e tyre e kështu me radhë", tha Meta.

Ekspozita e veçantë e PS dhe ministrisë së Kulturës Kosovë

# Rama 'ngre' flamurin kuq e zi në Prishtinë

Lame e Shkreli: 20 flamujt që bashkojnë kombin

## Lajmi

Kreu i PS Rama, deputetë e kuratorët e një ekspozite të veçantë në Kosovë, Artan Lame e Artan Shkreli, kanë udhëtuar dje për në Prishtinë, ku për dy ditë do ekspozojnë "Flamuj Shqiptarë-itinerar historik 1912-2012". Më 13-14 nëntor në Gjakovë, më 28-29 nëntor në Vlorë.



### Rama

Lideri i opozitës ka akuzuar qeverinë se ka ndjekur politika antikombëtare sa i përket arsimimit. Gjatë prezantimit të programit socialist në një takim në Tiranë, Rama u shpreh se ky sektor kërkon politika të reja.

■ ■ ■ TIRANE  
JAKIN MARENA

rorët. Kontributin e vet për flamuj, brenda këtyre 20 tipeve që do të shihen në këto ekspozita, e ka dhënë edhe Kosova. Ato nuk janë pjesë e shtetit. Janë pjesë e individëve të apasionuar, dhe asnjëherë më parë s'janë bërë publikë. Edi Rama dhe ministria e Kulturës së Kosovës mbështetën këtë iniciativë. Një pjesë e mirë e fotografive do të jenë me ngjyra. Në të gjitha këto fotografi, që kanë flamujt, dhe kanë një përmbajtje historike, janë kurruar jashtë vendit për ngjyrat,

në studio grafike të cilësive të lartë. Ndërkohë që mes këtyre perlave fotografike është dhe një foto shumë të rrallë e të pabotuar të kolonelit Tomson, në momentet e fundit të jetës, i cili ishte i mbuluar me një flamur të madh shqiptar. Që do të jetë pjesë e kësaj ekspozite.

mur të madh janë duke parë një foto shumë të rrallë e të pabotuar të kolonelit Tomson, në momentet e fundit të jetës, i cili ishte i mbuluar me një flamur të madh shqiptar. Që do të jetë pjesë e kësaj ekspozite.



Edi Rama dhe Artan Lame

## Rama, reagimi:

### "Kryeministri mund të ndjehet mbi ligjin deri në qershor"

Kryeministri mund të ndjehet mbi ligjin e mbi vendimet e gjykatës deri në qershor, po ne s'ia njohim si të drejtë këtë abuzim flagrant me pushtetin. Ky ka qënë reagimi i Ramës pas deklaratave të Berishës për ligjet dhe Fierin. "Kush e beson se po ta donte vërtet statusin e kandidatit, do e mbante peng qarkun e Fierit në shkëlqje të vendimit të gjykatës?! S'ka zgjidhje politike mbi vendimin e formës së prerë të gjykatës e për këtë parim ne kemi pranuar e vendime skandalozë gjykatash" tha Rama në Twitter.

## Berisha për Fierin:

# Mocion besimi, Rama frikë nga këshilltarët

■ ■ ■ TIRANE



Sali Berisha

Seanca e ardhshme plenare do të jetë s'vëndimtare për votimin e ligjeve që kanë mbetur pezull dhe që kërkojnë 3/5 e votave të deputetëve në Parlament. Kjo bëri që kreu i qeverisë, Sali Berisha të përsërisë apelin për kryetarin e opozitës që të votojë 3 ligjet e kërkuara nga KE-ja, për t'i dhënë Shqipërisë shansin e anëtarësimit në Bashkimin Europian. Duke iu referuar kushtetimit të PS për votimin e këtyre ligjeve me zbatimin më parë të vendimit të Gjykatës së Lartë për kryetarin e Këshillit të Qarkut të Fierit, Berisha i kërkoi Ramës që të bëjë mocion besimi për këtë problem dhe në mënyrë të tillë që të mos mbajë të bllokua statusin. "Nëse do votohen këto 3 ligje, do të vendosin që rekomandimi i KE të shqiptarëve, bllokimi në këtë vit zotj rastin të ftoj zotin Rama të votojmë ligjet. Unë besoj se do të ishte një përgjegjësi shumë e madhe para çdo qytetari shqiptar, para ëndrrës evropiane të shqiptarëve, bllokimi në këtë vit të 100 të pavarësisë së Shqipërisë, apo votimi kundër faktikisht në parlamentin shqiptar për ligjet e kërkuara", u shpreh kryeministri. Sipas shefit të

qeverisë, pretendimet e opozitës se mocioni nuk ekziston si mundësi për të zgjidhur ngjarcin janë qesharake. "Ju kemi dëgjuar një ofertë që unë kam bërë ditët e fundit dhe natyrisht oferta ime ka si synim vetëm hapjen e rrugës dhe krijimin e mundësive për opozitën, që të dalë nga orbita bllokuese në të cilën është pozicionuar. Ligji përcakton të drejtën e anëtarëve të këshillave të ko-

munave dhe bashkive për të zgjedhur dhe shkarkuar anëtarët e këshillave të qarqeve. Neni 32 është zbatuar, aplikuar me mocion mosbesimi nga Partia Socialiste dhe duke u bazuar në këtë nen, PS në komunën e Bubullimës ka shkarkuar me votëbesim përfaqësuesin e kësaj komune, i cili ishte i mazhorancës dhe ka vendosur anëtarin e PS ose anëtarin e këshillit të PS. Dhe e ka bërë këtë pa asnjë lloj objeksioni nga ana e PD-së, sepse nuk na shkon ndër mend të vëmë në dyshim të drejtën e këshillave të bashkive dhe komunave për të zgjedhur dhe shkarkuar anëtarët e këshillit të qarkut që përfaqësojnë bashkinë apo komunën", tha Berisha.

### JO 2 KRYEMINISTRA

Kryeministri komentoi edhe kushtin tjetër të kreu të PS-së, që lidhet me Reformën Parlamentare, duke theksuar se mazhoranca ka pranuar kërkesën që kreu i opozitës të flasë pas kryeministrit në Kuvend, por sipas tij, Rama kërkon që në rregulloren e parlamentit vendi të ketë 2 kryeministra. "Më është kërkuar që pas fjalimit të kryeministrit, a mund të pranohet që të ndryshohet rregullorja dhe ta marrë fjalën kreu i opozitës. Unë e pranova, por jo 2 minuta siç kërkoihej

por 10 minuta, zoti Rama thotë jo. Dy kryeministra nuk krijohen kurrë. Ç'është kjo ethe e tmerrshme e tij për tu shpallur kryeministër me ligj dhe jo me vota? Tani sa del thotë unë kryeministri i ardhshëm, si reja në horizont që largohet. Kur të kapin ethet ndonjëherë, se unë jam mjek, janë shumë problematike. Këtë e kanë kapur ethet e pushtetit dhe nuk di se çfarë bën. E ka të vështirë të orientohet."- vijoi më tej Berisha.

### AKUZA SHTYTYPIT

Kryeministri Berisha kritikoi drejtuesit e gazetave, që sipas tij po përdorin së shumti lajmet e kronikës për të hapur gazetave e tyre, duke thënë se kjo është një sëmundje nga e cila dëmtohet shtypi dhe jo qeveria. "Janë dy Shqipëri, njëra Shqipëri e titujve të gazetave dhe për fatin më të keq, si në asnjë vend tjetër të planetit, Shqipëria e gazetave është Shqipëria e kronikës së zezë. Si një mik absolut me respekt absolut për shtypin, ndiej një keqardhje shumë të thellë kur seria e tërë gazetave të vendit tim, gazeta serioze me drejtues profesioniste, hapen me gërma kapitale me kronikën e zezë. Kjo është një sëmundje", tha Berisha.



**Integrimi, Sequi:**  
**Vendet aspirante t'i nënshtrohen reformave**

Duke folur në konferencën ministeriale "Europa Juglindore- 2020 Drejt Konvergjencës dhe Rritjes" ambasadori i BE-së në Tiranë, Ettore Sequi, theksoi se vendet që aspirojnë në BE duhet t'i nënshtrohen një sërë reformash. "Kërkohet punë e përbashkët sa i përket politikave ekonomike pasi koha na detyron të punojmë me përkushtim. Kriza në vazhdim na shtyn për

të ndërmarrë hapa të mëtejshme. Kriza ka bërë që BE-ja të nënshtrohet rregulla të reja për të pasur një qeverisje sa më të mirë", tha Sequi. Kreu i prezencës së Bashkimit Europian në Tiranë, Sequi i pranishëm në konferencën "Evropa J-L 2020", deklaroi se vendet që aspirojnë në BE duhet t'i nënshtrohen një sërë reformash. Ambasadori Sequi theksoi se

kriza ekonomike ka detyruar BE të rishikojë disa rregulla, teksa shtoi se Europa mbetet e angazhuar për të ndihmuar vendet e Ballkanit Perëndimor. I pranishëm në këtë konferencë, zv.kryeministri dhe ministrit të Ekonomisë, Tregëtisë e Energjitikës Edmond Haxhinasto, objektivat e BE do t'i çojnë vendet e Europës Juglindore drejt zhvillimit.

Ministri Panariti ftoi 18 presidentë, 47 ministra të Jashtëm

# KiE, dështon qeveria bojkotohet ceremonia

Shqipëria dorëzon Presidencën te Andora

TIRANE

Lajmi

JAKIN MARENA

**Dorëzimi i Presidencës së KiE nga ana e qeverisë shqiptare është bërë vetëm në prezencë të kreut të qeverisë së Andorës, vendi i që merr presidencën e radhës. Ndërsa ministri i Jashtëm Panariti më 3 tetor premtoi se do ishin 18 presidentë e 47 ministra të Jashtëm.**

Dështon ceremonia e Dorëzimit të Presidencës së Këshillit të Evropës. Qeveria shqiptare për të bërë këtë ceremoni dorëzimi kishte ftuar 18 Presidentë dhe 47 ministra të jashtëm, por ka ardhur vetëm kreu i qeverisë së Andorës i cili mori çelësat e drejtit sipas rotacionit drejtues dhe ku vendi ynë sipas të gjitha gjasave do të ketë shansin të ketë drejtimin e KiE pas 23 vitesh. Premtimin për ardhjen e 18 Presidentëve dhe 47 ministrave të Jashtëm e ka bërë vetë ministri i Jashtëm

shqiptar Edmond Panariti më 3 tetor, vetëm 36 ditë më parë. Panariti, Ministër i Jashtëm më 3 tetor 2012 tha se "Presidencën shqiptare është vlerësuar shumë për seriozitetin, për cilësinë dhe numrin e aktiviteteve që ajo ka realizuar brenda mandatit të saj dhe kurorëzimi i presidencës shqiptare pa dyshim, do jetë aktiviteti shumë i madh që do

organizohet në datat 8 e 9 nëntor në Tiranë, kur nën moton "të bashkuar në diversitet" ne do të ftojme në këtë aktivitet 47 ministrat e jashtëm të KiE dhe 18 presidentë. Do të jetë një format që vendi ynë nuk e ka pare...". Asnjë nuk erdhi. Kështu Shqipëria e mbylli dje kryesimin e Këshillit të Ministrave të KiE në një ceremoni e cila dësh-

toi tërësisht për shkak të mos përgjigjes ndaj ftesave që kishte shpërndarë qeveria shqiptare. Bojkoti flagrant i Perëndimit ndaj një ceremonie e cila synonte të përdorte rotacionin formal të Këshillit të Evropës për imazh politik tregon se Perëndimi është bërë i kujdesshëm në përpjekjet e tij për t'i hequr mundësinë qeverisë së Tiranës që ta përdorë për kapital politik, tashmë që vendi ka hyrë në vitin elektoral. Por një nga elementet më të dalluar të kësaj ceremonie ishte se Berisha e ka listuar atë në ceremonitë për nder të 100 vjetorit të pavarësisë, duke vënë dyfish në pozitë të vështirë Këshillin e Evropës e ftesën Kombëtare, të cilën e bojkotuan të gjithë



**Panariti më 3 tetor**

Edmond Panariti, Ministër i Jashtëm tha më 3 tetor: "Presidencën shqiptare është vlerësuar shumë për seriozitetin, për cilësinë dhe numrin e aktiviteteve që ajo ka realizuar brenda mandatit të saj dhe kurorëzimi i presidencës shqiptare, pa dyshim, do të jetë aktiviteti shumë i madh që do të organizohet në datat 8 dhe 9 nëntor në Tiranë, kur nën moton "të bashkuar në diversitet" ne do të ftojme në këtë aktivitet 47 ministrat e jashtëm të KiE dhe 18 presidentë. Do të jetë një format që vendi ynë nuk e ka pare...".

të ftuarit. Në fakt nuk pati një bilanc se çfarë bëri Shqipëria këto gjashtë muaj. Por në këtë ceremoni s'erdhën as drejtuesit e lartë të KiE, që Berisha s'ngurroi t'i përshëndesë dhe pse i ndërprente fjalën në

Asamblenë e Përgjithshme. Tani presidencën e merr Andorra, që e ka një angazhim konkret: këtë presidencë do merrtet me arsimin. Në Konferencë përpos kreut të shtetit Nishani, kryeministrit Berisha dhe shefit të diplomacisë shqiptare, Panariti mori pjesë si i ftuar special Sampaio, Përfaqësues i lartë i OKB e ish-President i Portugalisë, Bonino, Zv/Presidente e Senatit Italian, Licht, anëtare e Grupit të Personave të Shquara, hartues të raportit "Të jetojmë së bashku", etj. Panariti i dorësoi në mënyrë simbolike çelësin e Kryesisë së KiE homologut andoren. Berisha tha se Qeveria do bëjë gjithçka për mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare me standarde ndërkombëtare", teksa ftoi Këshillin e Europës të dërgojë vëzhgues të zgjedhjet parlamentare të 2013. Kryeministri Berisha ndër të tjera vlerësoi tolerancën shqiptare si shembull në bashkëjetesën e qetë. Kreu i Shtetit Nishani teksa vlerësoi punën e realizuar nga vendi ynë përgjatë këtyre 6 muajve, kur vendi ynë kishte presidencën e KiE ritheksoi qëndrimin se rekomandimet e BE mbeten prioritet për Shqipërinë. Nishani tha se gjatë kësaj periudhe, Shqipëria pati mundësi të tregojë se ka institucione të konsoliduara. Prioritetet e Shqipërisë në planin kombëtar e ndërkombëtar mbetet bashkëpunimi rajonal ndërmjet vendeve të Ballkanit. Ai apeloj të angazhohet për një shtirrje më të gjërë të organeve të saj në Kosovë.

100 vjetori

## Topalli nderon komunistë dhe nacionalistë

Në kuadër të 100 Vjetorit të Pavarësisë, Kuvendi vijon të nderojë figura të shquara, ata burra dhe gra që dhanë një kontribut të çmuar dhe

sakrifkuan deri me jetë, në historinë tonë kombëtare. Kryetarja Jozefina Topalli i dorëzoi botimin special të Kuvendit "Aktet e themelimit të shtetit

shqiptar" familjarëve të atyre që kontribuan në rezistencën kundër fashizmit e kundër komunizmit, duke filluar nga Qemal Stafa e deri te Muhar-

rem Bajraktari. Në ceremoni u nderuan dhe grupi i deputetëve të ekzekutuar në gjyqin special të vitit 1946-1947. "Në këtë 100 vjetor të pavarësisë, jemi mbledhur në tem-



pullin e demokracisë për të nderuar me përvëlje dhe mirënjohje, ata bij të Shqipërisë që në themelet e shtetit vendosën pa droje shpirtin, pasionin e deri dhe jetën e tyre", ka deklaruar Topalli. Sipas të cilës, të gjithë ata burra e gra, vajza e djem që këtë vend e dëshën deri në sakrificën sublimë, e dëshën njësoj pavarësisht se ai shekull i çmendur të lejonte ta shihje vetëm nga e majta ose nga e djathta, me një xheloz kapricioze që i kushtoi njerëzimit 2 luftëra botërore e një luftë të "ftohtë" 45 vjeçare. Më tej, kryetarja e Kuvendit Topalli i dorëzoi botimin special të Kuvendit të Shqipërisë "Aktet e themelimit të shtetit shqiptar" familjarëve të atyre që kontribuan në rezistencën kundër fashizmit dhe kundër komunizmit duke përfshirë komunistë dhe nacionalistë.

**KUSH U NDERUA NGA KUVENDI**

■ Abaz Kupi	monarkist
■ Sejfulla Malëshova	komunist
■ Qemal Stafa	komunist
■ Mit'hat Frashëri	ballist
■ Mustafa Gjinishi	Komunist
■ Ymer Dishnica	komunist
■ Gani Kryeziu	antifashist
■ Muharrem Bajraktari	nacionalist
■ Abaz Shehu	komunist
■ Asim Zeneli	komunist
■ Safet Butka	ballist
■ Margarita Tutulani	komuniste
■ Kristaq Tutulani	Komunist
■ Shefqet Beja	nacionalist
■ Riza Dani	nacionalist
■ Sheh I. Karbunara	nacionalist
■ Irfan H. Majuni	ish-deputet
■ Prof. Kol Prella	nacionalist
■ Islam Radovicka	ushtarak
■ Faik Shehu	nacionalist
■ Enver Sazani	ish-deputet
■ Selaudin Toto	nacionalist
■ Kol Kuqali	ish-deputet
■ Hysni Pejas	nacionalist
■ Kostandin Boshnjaku	PSD
■ Kadri H. Hoxha	antifashist
■ Arif Gjylji	ish-deputet
■ Osman Kazazi	ballist
■ Mikel Koliqi	antikomunist

**KABINETI SALAJ**

**APARATE DËGJIMI**

Mbi bazën e një experience 10-vjeçare në fushën e vendosjes së APARATEVE të dëgjimit kabinetit "SALAJ" ju vjen në ndihmë në këto shërbime:

- ☞ Matjen e dëgjimit (audiogram) FALAS.
- ☞ Marjjen e masës si dhe përgatitjen e saj (silikon apo akrilike) në kohë rekord brënda dy ditëve.
- ☞ Përcaktimin dhe programimin e aparatit sipas shkallës së dëgjimit.
- ☞ Shërbime (servis) për të gjitha tipet e aparateve.

**Adresa:** Pallatet e Shallvareve, Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, përballë Taiwan Nd. 24, Shk. 4, Ap.5 - Tiranë  
**Tel:** +355 4 2262 304 / **Mob:** 068 23 800 95  
**E-mail:** info@salajakustik.com  
**Website:** www.salajakustik.com



## Berisha: Bashkimi kombëtar, synim i çdo shqiptari

Shqiptarët duhet të ruajnë si të shenjtë idealin e bashkimit kombëtar në këtë 100-vjetor të Pavarësisë. Kryeministri Sali Berisha ka bërë thirrje që të gjithë shqiptarët në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe në të gjitha trojet shqiptare, duhet të synojnë bashkimin dhe unitetit kombëtar si dhe ëndrrën e çdo shqiptari për integrim në Bashkimin Evropian. "Të ruajnë si

idealin më të shenjtë të shqiptarëve, idealin e bashkimit kombëtar. Trojet etnike të shqiptarëve duhet të jenë dhe janë territore të ndërgjegjes së tij kombëtare, kudo që ai jeton. Ky është një kusht vendimtar, që energjitë e kombit të shkojnë për ndërtimin e të ardhmes së tij në liri. Ne kemi humbur kohë, jo se kemi dashur vetë, por sot të lirë ne ecim me shpejtësi më të madhe sesa të

tjerët", është shprehur Berisha. Sipas tij, dhe në këtë 100-vjetor nderimi më i madh u bëhet qindra e mijëra të rënë nga fillimi i shekullit të shkuar deri në vitet '99 dhe 2001, në Kosovë e Maqedoni, "është të bëjmë çdo gjë për t'u bashkuar me njerëz tjetër, është të bëjmë çdo gjë për tu bashkuar me Evropën".

### ZGJEDHJET 2013

Kreu i Asamblesë së PS: Do marrim mbi 71 vota

# Ruçi: Fitojmë pa LSI, Malaj jo kundër Grupit

"Sali Berisha e do Fierin për 2013-tën"

### Lajmi

Kreu i Asamblesë dhe i grupit të PS Ruçi tha se zgjedhjet PS do ti fitojë dhe pa LSI, ndërkohë që tha se FRD e AK janë të djathta por duan rotacion. Ai këmbënguli se do fitojnë mbi 71 deputetë, ndërsa tha se Malaj duhet të respektojë grupin për Fierin.

### TIRANE

ALFRED PEZA

Në një intervistë për emisionin "Debat" në Vizion Plus kreu i grupit të PS, Gramoz Ruçi tha se do fitojnë dhe pa LSI.

Sot mediat raportuan se qeveria i ka dhënë paratë Lirak Bejkos dhe ish-të burgosurve të tjerë grevistë...

Çrëndësi ka kjo, ai rahmetliu iku. Dy vajzat e tij janë jetime tashmë. Dhe fundja ata kërkuan "na beqenisi si njerëz" në radhë të parë. Ata ishin të dënuar se ishin kundër regjimit komunist, por dhe sot ata u dënuan se ishin bashkëpunëtorë të Edi Ramës. Rama u paska çuar dhe shishen me benzinë, dhe çakmakun për të ndezur veten e tyre. Duke ardhur sërish tek çështja e Fierit, Berishës nuk i intereson asgjë. E ka krijuar vetë me dorën e tij, sepse është përsëri për qëllime elektorale qarku i Fierit.

Pikërisht, a ka lidhje me zgjedhjet e 2013-ës Qarku i Fierit?

Absolutisht. Nuk ia toleron dot Sali Berisha humbjen e qarkut të Fierit...

Kush është lidhja këtu?

Është pikërisht rezultati dhe diferenca që janë tre mandate në 2009-ën të opozitës ndaj mazhorancës. Dhe ai e di mirë që duke e goditur Qarkun e Fierit, për ta nënshtruar atë, të ulë dhe të minimizojë rezultatin e mazhorancës socialiste në Qarkun e Fierit. Dhe gjithçka ka të bëjë me fushatën elektorale, dhe kjo që po ndodh është fryma e kësaj fushate elektorale. Dhe kjo është e patolureshme. Dhe ne jemi të vendosur për këtë çështje.

Malaj ka deklaruar se nëse i largohemi Brukselit prej Qarkut të Fierit atëherë kjo do jetë kosto për PS-në...?

Unë e respektoj. Këtë mendim e ka shprehur edhe në mbledhjen e parafundit të grupit PS-së, dhe unë ia kam dhënë përgjigjen. Sigurisht nuk më er-



dhi aspak mirë që pas këtij sqarimi dhe kësaj vendimmarrjeje, dhe pas atij debati politik që unë zhvillova me kryeministrin dhe me ofertën e tij politike, Ben Malaj shprehu të njëjtin qëndrim që pohuat dhe ju kundrejt të asaj që porsa thatë. Do ishte mirë që Malaj të ishte në mbështetje të këtij vendimi të grupit sepse në fund të fundit këto janë rregullat në demokraci.

Përveç kësaj ka patur edhe një debat nga z. Malaj, që ka patur të bëjë me bilokimin e valëve të celularit në Asamblesën e PS-së...?

Në forumet politike që ekzistojnë në të gjithë botën demokratike, ka probleme të brendshme të tyre, në të cilat vihet, ka një rregull, ka një etikë, që kur futen në mbledhje dorëzohen celularët tek dera. Kështu që vetëm tek ne mungon kjo mungesë etike. Por këtë çështje e mori dhe e përdori Berisha si alibi. Por ai përpara se të merrte me PS të na thotë se si i drejton ai mbledhjet e qeverisë dhe të grupit të tij parlamentar. Ndaj kjo s'ka të bëjë se atij i interesojnë shumë celularët e PS, por e ka merrak tek përgjimet. Sepse nuk mori vesh dot gjë se çfarë u vendos e që u diskutua në mbledhjen e Asamblesë Kombëtare të PS.

Po në rast se BE në dhjetor rrezon statusin, keni kosto...?

Absolutisht s'kemi asnjë kosto ne. Këtë kërkoi Sali Berisha me gjithë këtë demagogji që bën. Nëse unë i thashë "kokrra e mashtrestit", pikërisht ai këtë do të bëjë.

Ku jeni ju sot me krijimin e një fryme fituese?

Është ekipi që bën të mundur këtë çështje. Dhe PS nuk vuan nga kjo çështje. S'është PD me të famshmin KOP-i, që rezultoi vetëm demagogji elektorale. Dhe lista jonë do të jetë e gjërë, nuk do jetë me 70 vota, por me 140

### Debatet

"Unë e respektoj mendimin, apo propozimin që bëri në mbledhjen e grupit. Po kaq respekt duhet të ketë Arben Malaj e çdo emër i përvetshëm në mbledhje të grupit për vendimmarrje kolegjiale, sepse në një familje politike, ashtu si dhe në familjen biologjike e mban moralin, sikurse shtetin e mban ligji dhe partitë politike i mban rregulli, i mbajnë normal".

veta. Me aleatët tanë do bëjmë të mundur të kemi një mazhorancë të fuqishme e stabil për të qeverisur vendin për 4 vitet e ardhshme.

Si do jetë kjo aleancë e ardhshme?

Ne po punojmë në dy pistat. Pista e parë është që ne jemi forca opozitare

"Zonja Klinton në mënyrën më të çiltër, më të hapur tha: Ju lutem, pas 22 vjetësh, ne amerikanët ju lutemi bëjini më së fundmi zgjedhje të lira dhe demokratike"

kryesore, dhe alternativa jonë është që ne duam të marrim përgjegjësinë e të qeverisurit të vendit. Që elektorati të na japë mandatin për të qeverisur Shqipërinë. Ne jemi të gatshëm, dhe nuk ka ndonjë filozofi të madhe këtu, jemi të hapur se kush është i gatshëm për domosdoshmërinë e rrotacionit për domosdoshmërinë e rrotacionit të pushtetit ku bën pjesë edhe LSI-ja. Qëndron LSI në pushtet deri në ditën e zgjedhjeve apo jo, është qëndrimi i tyre.

Rama merret vetë edhe me këtë çështje, dhe do jetë një koalicion elektorale, dhe qeverisë me një numër të konsiderueshëm partish politike, që do bëhen nëpërmjet miratimit të marrëveshjeve politike që do bëhet publike në kohën e duhur.

Do të hyni në koalicion edhe me parti të djathta?

Unë kur thashë që portat e PS janë të hapura për çdo parti që ka këto dy objektiva: e para programin, e dyta që është e gatshme që të bëhet rotacioni politik.

E keni fjalën për partinë e z. Bamir Topi dhe Aleancës Kuqezi?

Po. Dhe ne e respektojmë atë. Këto dy parti kanë dalë nga e djathta...

Topi ka deklaruar që s'do bëjë koalicion me PS...?

Në radhë të parë në politikë kurrë mos thuaj kurrë. Unë edhe mbrëmë e kam dëgjuar publikisht Edi Ramën, që kur pyet për këto dy parti, ka thënë që janë parti të dala nga e djathta. Unë respektoj programin e tyre, alternativën e tyre, i respektoj dhe për atë që të dy janë shprehur absolutisht për domosdoshmërinë e rrotacionit, i inkurajoj në këtë drejtim, dhe i uroj sukses.

Si do i përgjigjesht atyre që mendojnë se PS nuk vjen dot në pushtet në qoftë se nuk është në aleancë me LSI-në?

Përgjigja është e qartë, dhe nuk është e teoritike, është praktike. Sepse po ti referohemi zgjedhjeve të 2009-ës, PS fitoi. S'e kishte në koalicion LSI-në, ajo ishte më vete. Në 2007-ën ne ishim në koalicion me LSI-në në zgjedhjet për pushtetin vendor. Dhe në 2011-ën nuk ishim në koalicion me të. Po marrim zgjedhjet në Durrës. Kur ishim në koalicion me LSI-në, zotë Dako fitoi me 300 vota. Pasi ndenji 4 vjet në pushtet, pa koalicion me LSI-në, biles LSI-ja kundër tij, rezultati elektorale ishte jo vetëm fitues, jo vetëm me 300 vota, por shumë herë më tepër. Po ashtu në Elbasan, në Korçë, Pogradec, në Lushnjë, në Fier, në Vlorë. Kështu që nuk është e vërtetë kjo, që e pa këtë ne nuk vijmë në pushtet. Çështjen e LSI ne e kemi biseduar dhe një herë tjetër: ata janë në pushtet, ne jemi në opozitë. Ata do luftojnë që të mbajnë pushtetin, ne kemi tjetër alternativë: domosdoshmërinë e rrotacionit të pushtetit ku bën pjesë edhe LSI-ja. Qëndron LSI në pushtet deri në ditën e zgjedhjeve apo jo, është qëndrimi i tyre.

Pra me LSI-në, apo pa LSI-në, pa AK-në dhe pa FRD-në...?

Me to apo to, ne nuk jemi nisur fare me këtë punë. Ne kemi një objektiv elektorale, kemi një ofertë, ne kemi një ekip, ne kemi një alternativë. Nga të gjitha testet që janë bërë, por dhe në testin e bërë para një viti, shqiptarët na kanë besuar. Ne duhet ta justifikojmë.



## Ambasadori holandez:

### Nuk jeni gati për

### Statusin për në BE

Në numrin e sotëm, revista Java boton një intervistë me ambasadorin holandez në Tiranë, Martin de la Beij, i cili komenton vendimin e qeverisë holandeze për të mos votuar pro dhënies së statusit të vendit kandidat për Shqipërinë, në Këshillin Europian të dhjetorit. "Holanda është e mendimit se Shqipëria nuk është ende gati për statusin e vendit kandidat. Ne e përshëndetim

faktin se është bërë shumë punë dhe ka arritje në këto një vit e gjysëm, këtu mund të përmend emërimin e Avokatit të Popullit, ndryshimet në Kodin zgjedhor e ligjin për imunitetet. Por tani është tejet e rëndësishme që Shqipëria të japë prova konkrete që këto ligje janë vënë në funksionim dhe zbatohen", thotë Beij. Sipas tij do ishte shumë pozitive të shikohet që të behet progres në lidhje me

çështjen e të drejtave të pronësisë dhe sigurisht, të sigurohen që zgjedhjet do të zhvillohen sipas standardeve ndërkombëtare. Ky qëndrim i qeverisë holandeze e nxjerr të panevojshëm dhe demagogjik debatin politik aktual rreth votimit të ligjit për Gjykatën e Lartë, statusin e nëpunësit civil e rregulloren e Parlamentit. Vendi ynë ka disa probleme të tjera më të thella sesa këto.

## INTERVISTA

Senatorja italiane, në Tiranë për mbrojtjen e të drejtave të pakicave

# Bonino: Mos e humbni Europën

Apeli i Emma Boninos për demokracinë e brishtë në Shqipëri dhe ruajtja e vokacionit europian. Mirëkuptimi për kërkesat e opozitës, por edhe këshilla se tango kërcëhet dyshe

## Lajmi

Emma Bonino, senatorja e mirënjohur italiane, gjatë një interviste në "A1 Report" uroi që Shqipëria të mos e humbasë rrugën drejt Europës, vokacionin e saj europian. Ajo ishte pjesëmarrëse në ceremoninë e dorëzimit të presidencës së KiE nga Shqipëria, në mbrojtje të diversitetit njerëzor.

■ ■ ■ TIRANË

INDRIT MARAKU

Senatorja e njohur italiane, Emma Bonino ishte dje në ceremoninë e dorëzimit të presidencës së Këshillit të Europës nga ana e Shqipërisë. Në një intervistë për "A1 Report", zonja Bonino, e angazhuar në diversitetin në Europë, flet për mbrojtjen e të drejtave të minorancave, qofshin këto homoseksuale apo minoranca fetare, emigrantëve dhe romëve, në të gjitha vendet e Këshillit të Europës.

**Senatorja Bonino, në rradhë të parë faleminderit për intervistën.**

Ju lutem, ju lutem!

**-Ju sot prezantuat një raport këtu në Tiranë mbi diversitetin në Europë. Mund të na thoni cilat janë pikat më të rëndësishme të tij?**

Ishte një raport i komisionuar nga Këshilli i Europës që ka formuar një grup prej 9 personash, i kryesuar nga Joshua Fisher. Puna ka filluar në 2010 dhe e kemi publikuar nga gjysma e 2011. Nga një anë kemi bërë një fotografi të situatës, të mbrojtjes së të drejtave të minorancave, qofshin këto homoseksuale apo minoranca fetare, ose çështja e emigrantëve apo çështja e romëve, në të gjitha vendet e Këshillit të Europës.

Fotografia që doli nuk është shumë brilante. Duhet të konstatojmë që nga një anë kemi traktatet që janë shumë të mira, dhe në fakt ne nuk propozojmë një traktat të ri, ndërsa nga ana tjetër kemi një praktikë politike që lë shumë për të dëshiruar. Dhe kjo në shumë vende anëtare të Këshillit të Europës. Secili vend është pak ndryshe nga tjetri. Ka vende që nuk respektojnë ashtu si duhet romët, ka të tjerë që janë shumë pak të respektueshëm për sa i përket të drejtave të minorancave seksuale, të tjerë për sa i përket minorancave fetare, sepse çdo

vend përballat me historinë e tij, me prapambetjen e tij. Dolëm me rreth 50 rekomandime. Ne e shikojmë çështjen e diversitetit si një pasuri dhe jo një motiv përjashtimi.

**-Duke folur më konkretisht për Shqipërinë, një raport i fundit i Amnesty International që praktikisht thotë se romët persekutohen nga autoritetet.**

Kjo është një situatë e përhapur. Ne e kemi parë dhe stigmatizuar edhe në vendin tim ku gjykata kohët e fundit e ka shpallur ilegal një plan emergjence-rom që ishte bërë nga qeveria e mëparshme. Sot po tentohet rruga e integritimit që nuk është shumë e lehtë. Shembuj të tjerë, për romët, kemi folur psh. në një takim në Hungari, ose në Rumani, ku ende është një problem me

**Të uleri në një tavolinë tratativash si europianë. Nuk ka asnjë vend që mund të ja dalë i vetëm. As Gjermania. Pra mesazhi im është fiks ky: çfarë është pavarësia sot?**

ve. Pra, besoj se Shqipëria nga kjo pikëpamje ka ndjekur praktikën e këqija që janë të përhapura edhe në vende të tjera. Këtë nuk e them për të justifikuar por për të theksuar se një bashkëpunim praktikash të mira mund të ndihmojë.

**-Në këto vende që përmendët, janë autoritetet edhe aty që persekutojnë romët si në rastin e Shqipërisë apo është shoqëria në përgjithësi?**

Dy aspektet janë të lidhura. Sigurisht, përfaqësuesit politikë kanë edhe detyrimin që të japin shembullin e mirë. Në vendin tonë kemi pasur refuzime si për sa i përket romëve ashtu edhe emigrantëve, me impostime të qarta edhe raciste, nga ndonjë ekspoz

cent i Lega Nord që ishte në qeveri.

**-Në Shqipëri kemi një ligj kundër diskriminimit të homoseksualëve, por kur arrijmë te praktikatat, kemi raste zv/ministrash që dalin me deklarata që bëjnë thirrje për dhunë. Çfarë duhet të bëjë Shqipëria, çfarë duhet të bëjnë autoritetet për të respektuar edhe...**

...një proces demokratik quhet pikërisht proces dhe si e tillë një tolerancë demokratike fitohet çdo ditë. Ndonjëherë bëhen dy hapa para e dy mbrapa. Siç ju thoja, këtu ndoshta situata është më e lidhur me homoseksualët, në një vend tjetër të myslimanët. Pastaj ka vende ku i gjen të dyja, të treja, të katërta... Kjo do të thotë sipas meje se situata e Europës, që është e shkëlqyer nga pikëpamja e ligjeve, ka një praktikë në shumë vende që është shumë e dëmshme dhe negative. Janë të pakta edhe mjetet sanksionuese. Në mungesë të këtyre sanksioneve, gjëja më e rëndësishme sipas meje është informimi publik, kjo që bëni ju, dhe që duhet të përpiqemi ta bëjmë absolutisht. Besoj se ambasadorët europianë këtu në Tiranë kanë marrë pozicion ndaj këtij rasti që ju përmendni në lidhje me homoseksualët. Dhe kjo është shumë e rëndësishme. Mendoj se duhet të kemi kurajon për të reaguar, që të paktën opinioni publik, përballë dy opinionëve, të përpigjet të krijojë një opinion të vetin.

**-Ju u bëtë një fytyrë e njohur për shqiptarët në vitin 1999, koha e Luftës së Kosovës dhe e refugjatëve. Nëse shikoni Shqipërinë sot si ka ndryshuar?**

Ai që shoh sot është një vend në një proces demokratik të brishtë, në një proces institucional akoma edhe më të brishtë. Shoh një vend që unë shpresoj të mos humbasë vokacionin europian pasi kjo vend, ashtu si dhe ne, nuk ka alternativa të tjera. Në botën e globalizuar që kemi sot asnjë vend i vetëm nuk ja del të jetë i rëndësishëm në një takim. Jeni në një moment ven-

Në foto: Emma Bonino



vërteta, edhe mbi procesin zgjedhor. Por shpresoj që dy nivelet, ai i konfliktit të brendshëm dhe prespektiva europiane të mos ngatërrohen. Ka probleme që duhet të gjejmë një zgjidhje të brendshme dhe është perspektiva europiane për një të ardhme për ju të rinjtë shqiptarë, ashtu si dhe për të rinjtë italianë, që s'mund të jetë veçse europiane.

Shpresoj që pasi ta kenë kuptuar që duhet të jeshë dyshe për të kërcyer tango, kjo tango të kërcëhet. E dimë të gjithë që Europa nuk është në një moment aperturash të mëdha por mendoj se është e rëndësishme të jesh pjesë e kësaj familje të madhe që duhet rithemeluar, rishikuar. Kemi nevojë ta rikrijmë Europën dhe do më pëlqente që miqtë shqiptarë ta rikrijnë me ne.

**-Në fakt doja t'ju pyesja si e shihni rrugën e integritit europian të Shqipërisë por ma dhatë përgjigjen. Këtë vit, këtë muaj, në nëntor, Shqipëria feston 100-vjetorin e pavarësisë. Keni një mesazh për shqiptarët që na shohin?**

Po! Që në vitet Dymijë, pavarësia do të thotë ndërvarësi dhe të organizosh ndërvarësinë me të tjerët. Dhe që nëse dëshirojmë të vlejme diçka përballë miliarda kinezësh e miliarda indianësh, mund të vlejme vetëm si europianë. Të uleri në një tavolinë tratativash si europianë. Nuk ka asnjë vend që mund të ja dalë i vetëm. As Gjermania. Pra mesazhi im është fiks ky: çfarë është pavarësia sot? Pavarësia sot është të organizosh ndërvarësinë dhe ta organizosh në respekt reciprok në liri dhe demokraci. Unë nuk njoh një projekt tjetër tani përveçse atij të një Europe për t'u rikrijuar.

**-E thënë në një vend ballkanik, mendoj se mesazhi është i qartë. Faleminderit për intervistën!**

Faleminderit juve!

dimtar procedural për sa i përket rrugës europiane, unë shpresoj vërtetë që përgjegjësia e forcave politike t'i shtyjë të gjejmë një kompromis pasi e ardhmja europiane është një e mirë për vendin. Dhe për të bërë një kompromis... pra, për të kërcyer tangon duhet të jesh dyshe, përndryshe nëse dikush dëshiron kërcen vetëm, që është në rregull, por nuk është tango.

Nga pikëpamja ime, unë e kuptoj dhe simpatizoj për disa nga problemet që opozita ngren, pasi janë të



## Debati në ambasadë

**PËRPLASJA** e ideve dhe pikëpamjeve për politikë të jashtme në tokë neutrale. Përballë studentët e universitetit "Epoka" dhe UET dhe vota e tyre për Romney dhe Obama

# Kandidati i studentëve të UET fitoi në SHBA

## Zgjedhjet, përballja e studentëve në Ambasadën Amerikane

■ ■ ■ TIRANE

Zgjedhjet presidenciale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk mund të mos ngjallnin interesin e studentëve shqiptar të shkencave politike dhe kryesisht të atyre që studiojnë për marrëdhënie ndërkombëtare. Ndeshmëria e studentëve të Marrëdhënieve Ndërkombëtare për zgjedhjet në SHBA u pa që ishte e lartë që në një takim të organizuar disa kohë më parë në Bibliotekën Kombëtare me përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Tiranë. Interesit të studentëve profesori Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Enri Hide, ju përgjigj duke propozuar organizimin e një debati midis studentëve. Ideja e një debati të bazuar në tezaz e politikës së jashtme, që dy kandidatët kanë prezantuar gjatë fushatës, midis studentëve të Universitetit Europian të Tiranës dhe Universitetit Epoka u mirëprit edhe nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Debati u zgjodh të organizohej në tokë neutrale, pikërisht në ambientet e Ambasadës Amerikane në Tiranë. Secili prej grupeve të studentëve të dy universiteteve duhej të mbronte njërin prej kandidatëve për president. Debati ju përbajt rregullores së përgatitur më parë nga përfaqësuesit e Ambasadës së SHBA në Tiranë dhe zgjati më shumë se dy orë. Studentëve të dysh të mbronin tezaz e kandidatit të tyre dhe të kundërshtonin ato të grupit tjetër. I gjithë debati u zhvillua në gjuhën angleze për t'i dhënë akoma më shumë ngjyra amerikane sallës së dekoruar me elementet e fushatës presidenciale. Moderimin e debatit e mori përsipër z. Niles Cole nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun i cili u kujdes që të respektoheshin rregullat e debatit dhe drejtoi pyetjet mbi platformat zgjedhore të të dy kandidatëve.

Grupi i Universitetit Epoka përbëhej nga gjashtë studentët dhe kishte për të mbrojtur republikanin Romney gjatë këtij debate. Ata ishin përgatitur gjatë kësaj kohe rreth tezazve që Mitt Romney ka prashtruar rreth politikës së jashtme që duhet të ndjekin Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë mandatit të ardhshëm presidencial.

Grupi i studentëve të Universitetit Europian të Tiranës përbëhej nga pesë student të cikleve bachelor dhe master të programeve të Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Jona Hadërit, Fjolla Spanca, Megi Llubani, Gresa Hasa dhe Lulzim Hoxha duhej të mbronin në këtë debat tezaz e parashtruar nga presidenti aktual i SHBA, Barack Obama.

Studentët, para se të fillonin debatin, nuk haruan t'i shprehin keqardhjen për atë ndodhi në bregun lindor të SHBA ku gytete si Neë York u prekën nga uragani Sandy. Një përmbledhje e debateve presidenciale për grupet e studentëve dhe profesorët që i shoqëronin u shfaq para se të niste trajtimin i qasjeve të ndryshme të dy kandidatëve për president në SHBA e të mbrojtura nga studentët e dy prej

universiteteve më të mira në Shqipëri. Video përmbledhëse e luftës politike në media që kishin zhvilluar dy kandidatët përveçse shërbeu si hapje e debatit, i futi studentët në gjendjen dhe atmosferën krijuar gjatë debateve presidenciale.

Gjatë debatit studentët diskutuan dhe replikuan rreth çështjeve të politikës së jashtme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pikëpamjet që dy kandidatët për president i kishin trajtuar gjatë fushatës zgjedhore si roli i SHBA në botë, investimet në ushtri, marrëdhëniet me Paksitanin, tregtia e



Studentët e UET në ambasadën amerikane

jashtme me Kinën, etj. u rikultuan në debatin midis studentëve. Përveç tematikave të para-caktuara grupet e studentëve ju drejtuan pyetje edhe nga të pranishmit e tjerë në këtë debat studentor.

Në fund të debatit, moderatori z. Niles Cole falenderoi studentët që morrën pjesë dhe i përgëzoi për përgatitjen që kishin bërë duke studiuar platformat e politikës së jashtme të dy kandidatëve. Ai i dhuroi secilit grup nga një album fotografik dhe i ftoi për të ndjekur bashkë me Ambasadorin e SHBA në Tiranë, z. Alexander Arvizu, shpalljen e fituesit pas numërimit të votave.

## Diskutimet

# Studentët e UET shkurt për zgjedhjet

**Fjolla Spanca,** studente e vitit të tretë bachelor për Marrëdhënie Ndërkombëtare

**Obama apo Romney?**

Duke percjellur me vemendje politikaz e brendeshme dhe ato te jashtme, mendoj qe Obama qendron me me kembe ne toke.

**Në debatin e organizuar në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ju desh të mbronit platformën e Obama. Cila mendoni se është pika më e fortë e platformës së tij zgjedhore?**

Obama vazhdon të ketë një qasje më konstruktive kundrejt politikës së jashtme, përhapjes së demokracisë si dhe, padiskutim politikaz sociale të favorshme, sidomos për shtresat e vafera të popullsisë.

**Ju ka bërë më të interesuar për zhvillimet ndërkombëtare fakti që studioni Marrëdhënie Ndërkombëtare?**

Fusha të cilin zgjodha para tre vitesh është një det i pafundëm informacionesh, kuriozitetesh, të dhënash, strategjish e çka jo tjetër. Ndërthurja në mes historisë, shkencës politike dhe juridikut çfarë ngërthejnë marrëdhëniet ndërkombëtare, të jep një prizëm jo të zakonshëm analitik, kundrejt një qëndrimi objektiv, kritik. Kjo shton kërsërinë, interesin dhe vemendjen e theksuar për zhvillimet ndërkombëtare.

**Gresa Hasa,** studente në vitin e tretë Bachelor për Shkenca Politike.

**Obama apo Romney?**

Jam pro rizgjedhjes së Barack Obama-s për postin e presidentit të SHBA për arsye se gjatë këtij mandati nëpërmjet rigorozitetit e përkushtimit të vazhdueshëm, arriti të rimëkëmbte një Amerikë të lodhur dhe të përlur në shtë e botës nga gabimet e administratës Bush. Mbi të gjitha, jam e mendimit që përfaqëson katërcipërisht rolin e liderit amerikan dhe vlerat e këtij kombi në tërësi.

**Në debatin e organizuar në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ju**

**desh të mbronit platformën e Obama. Cila mendoni se është pika më e fortë e platformës së tij zgjedhore?**

Këmbëngulja e vazhdueshme për të investuar në arsim dhe teknologji si reflektim vital ndaj problematikave të politikës së brendshme dhe mundsisë së një konkurrence të paster dhe denjësisht të respektueshme me shtete në fuqizim e sipër, si Kina.

**Ju ka bërë më të interesuar për zhvillimet ndërkombëtare fakti që studioni Shkenca Politike?**

Unë studioj Shkenca Politika dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare zënë një vend kryesor në fushën time. Mund të them me siguri se analizat e vazhdueshme mbi çështje të ndryshme me karakter ndërkombëtar, studimi i teorive të marrëdhënieve mes shteteve dhe shumëllojshmëria e informacionit që përftohet përsa i përket ju vetëm marrëdhënieve politike shtetërore por sidomos natyrës njerëzore, ambicieve për të kërkuar gjithnjë më tepër hapësirë, më tepër pushtet, më tepër të mira, etj. të intrigojnë të duash të mësosh më tepër mbi këtë fushë dhe shtrirjen e saj në historinë botërore.

**Lulzim Hoxha,** student i Shkencave Politike

**Obama apo Romney?**

Pro presidencës së Obamës

**Në debatin e organizuar**

**në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ju desh të mbronit platformën e Obama. Cila mendoni se është pika më e fortë e platformës së tij zgjedhore?**

Mendoj se dy pikat e forta të Obamës ishte reforma e paketës së sigurimeve shëndetësore (në politikën e brendshme) dhe qasja e tij e mos-ndërrhyjes ushtarake në revolucionet arabe.

**Ju ka bërë më të interesuar për zhvillimet ndërkombëtare fakti që studioni Shkenca Politike?**

Në fakt më ka bërë më të interesuar për zhvillimet kombëtare, sepse edhe tema ime e diplomës përqendrohet në shoqëri shqiptare.

**Megi Llubani,** student në Master Shkencor për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Studime të Sigurisë, viti II

**Obama apo Romney?**

**Pro Obamës!**

**Në debatin e organizuar në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ju desh të mbronit platformën e Obama. Cila mendoni se është pika më e fortë e platformës së tij zgjedhore?**

Besoj se pikat më të forta të të platformës së tij të politikës së jashtme janë arritjet e mandatit të parë, pra: tërheqja e trupave nga Iraku, një luftë që Obama e ka cilësuar të panevojshme dhe një plan konkret për tërheqjen e përgjegjshme nga Afganistani deri në vitin 2014. Luftëra këto që I kanë kushtuar mjaft Amerikës financiarisht por edhe që e kanë dëmtuar imazhin e saj në politikën e jashtme.

**Ju ka bërë më të interesuar për zhvillimet ndërkombëtare fakti që studioni Marrëdhënie Ndërkombëtare?**

Për nga vetë emërtimi i fushës në të cilën studioj, Marrëdhënie Ndërkombëtare, përditësimi me zhvillimet ndërkombëtare është kusht i domosdoshëm. Duke ndjekur nga afër zhvillimet në arenën botërore, dinamikaz e bashkëveprimet ndërmjet shteteve në sistemin ndërkombëtar, lojërat e pushtetit ndërmjet aktorëve kyç të tij është thelbësore për krijimin e aftësive të mira analizeve dhe të shikosh përtej asaj që ofrojnë mediat.

**Jona Hadërit,** studente për Marrëdhënie Ndërkombëtare

**Obama apo Romney?**

**Obama.**

**Në debatin e organizuar në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ju desh të mbronit platformën e Obama. Cila mendoni se është pika më e fortë e platformës së tij zgjedhore?**

Nga shumë do veçoja planin e tij ekonomik afatgjatë për të investuar në edukim, infrastrukturë, energji të pastër, biznese të vogla, dhe ulje taxash.

**Ju ka bërë më të interesuar për zhvillimet ndërkombëtare fakti që studioni Marrëdhënie Ndërkombëtare?**

Më shumë nga çfarë mendoja fillimisht.



**I HIQET LICENCA SIMONCINI**  
"Urdhri i Mjekut" në bashkëpunim me ministrinë e Shëndetësisë ka vendosur të pezullojë licencën e mjekut italian, Tullio Simoncini, i cili aplikonte në vendin tonë mjekësinë alternative. Sipas "Urdhrit të Mjekut" vendimi ka ardhur pas denoncimeve të familjarëve të 27 vjeçarit italian, Luca Olivotto, i cili ndërroi jetë nga kura me sodë buke që i aplikonte mjeku italian në vendin tonë.



**TELEMJEKËSIA NË SHKODËR**  
Qendra e telemedicinës mbërrin edhe në Shkodër. Kjo falë një investimi prej 166 mijë dollarë, një projekt i koordinuar mes USAID, ministrisë së Shëndetësisë dhe Komandës Amerikane për Evropën. Ministri i Shëndetësisë, Vangel Tavo dhe ambasadori amerikan në Tiranë, Aleksandër Arvizu. Telemjekësia do të bëjë lidhjen e të gjitha spitaleve në një rrjet virtual duke shkëmbyer eksperiencën.

Autoritetet shqiptare: Bashkëpunimi do vazhdojë, përloten doktorët

# Mjekët: Kërkojmë falje s'e shpëtuam dot

Ekipi Irlandez: U përpoqëm 5 orë, por dështuam

## Lajmi

Vdekja e vogëlushit 11-vjeçar, D.A., është shkaktuar si pasojë e hipertermisë, që i mituri pësoi në mes të ndërhyrjes kirurgjikale në sy. Mjekët irlandezë, i kanë kërkuar falje familjes së të voglit, që nuk mundën ta shpëtonin, ndonëse ata u përpoqën për 5 orë e 30 minuta.

TRIANE

ESMERLADA KETA

Jack McCann, kirurgu irlandez, që kryesonte ekipin e mjekëve që operuan 11-vjeçarin D.A, katër ditë më parë, ka reaguar për vdekjen e pacientit. I pranishëm në konferencën e parë kirurgjikale maxilo-faciale, që organizohet nga QSUT në bashkëpunim me shoqatën "Irish Friends Of Albania", ai ka deklaruar se rasti i të miturit ishte një tronditje e madhe edhe për ta, ndaj i ka shprehur ngushëllime familjes dhe i ka kërkuar falje që nuk mundën ta shpëtonin dot. "Unë do të doja t'i shprehja ngushëllimet e mia familjes së Denisit të vogël, i cili vdiq këtë javë. Ai vdiq nga hipertermia që pësoi gjatë ndërhyrjes kirurgjikale dhe që ne nuk mundëm ta mbanim në kontroll, nuk mundëm ta shpëtonim. Unë dua që të gjithë të mendojnë pak për këtë djalë të vogël. Unë e takova Denisin e vogël fillimisht në 2006 dhe së bashku me ekipin tim e operuan së pari më 2007, dhe sërisht këtë javë, por fatkeqë-



Në rreth kirurgu irlandez Jack McCann që operoi 11-vjeçarin

sisht Denisin vdiq. Në vitin 2008 unë i kërkoja një koleg tim, që është i specializuar në procedurën e ptosis (sëmundja nga e cila vuante Denisin), operacionit të qepallave. Denisin nuk mund të shihet prej tyre. Mjeku erdhi pas katër vjetësh pasi ishte shumë i zënë gjatë kësaj kohe. Ishte një kërkesë e skuadrës sonë për ta operuar duke treguar mënyra të ndryshme të operimit të qepallave dhe trajnuar kështu edhe ekipet lokale të kirurgëve se si bëhet një operacion në qepallë, duke përdorur procedura të ndryshme. Bashkëpunimi jonë është i

vjetër me mjekët e spitalit "Nënë Tereza". Ne kemi operuar disa pacientë tek departamenti i Onkologjisë, me doktor Agim Karaj, te neurokirurgjia me doktor Mentor Pirellën. Rasti i Denisit ishte një shock për mua dhe skuadrën time. U përpoqëm për 5 orë e 30 minuta për t'i shpëtuar jetën por kjo ishte e pamundur. Ky ishte një rast që Denisin i vogël të ecte me kokën lart, pa u fshehur (nga sëmundja që kishte), por ne dështuam", - ka deklaruar mjeku irlandez, Jack McCann, i cili që në vitin 2002 vjen herë pas here në Tiranë për të kryer ndërhyrje të ndry-

shme kirurgjikale në QSUT.

## BASHKËPUNIMI

Gjatë kësaj konference, autoritetet shqiptare kanë deklaruar se ekipi i mjekëve irlandezë janë të shkëlqyer dhe ngjarja e ditëve të fundit nuk do të mund të eklipsojë as kontributin që këta mjekë kanë dhënë prej vitesh në dobi të pacientëve shqiptarë dhe as bashkëpunimin në të ardhmen me ta. "Dua të falenderojmë në mënyrë të veçantë mjekun dhe mikun tonë irlandez, Jack McCann, i cili së bashku me një ekip të specializuar mjekësh, prej vitesh kanë kon-



D.A që ndërroi jetë në QSUT

tribuar në mjekësinë shqiptare. Ngjarja e ndodhur ditë e fundit nuk do të eklipsojë as kontributin dhe as bashkëpunimin me ekipin e mjekëve irlandezë, të cilët janë të mirëpritur edhe për bashkëpunime të tjera në të ardhmen", - kanë deklaruar përfaqësuesit e shoqatës së ORL-së, në vendin tonë, deklaratatë që është përsëritur edhe nga homologët kosovarë. Por duket se mbështetja e madhe nga mjekët shqiptarë, e kanë prekur kirurgun irlandez, të cilin, nga paneli ku ishte ulur, nuk ishte e vështirë të dalloje që filloi të përlotej dhe fshinte vazhdimisht sytë. Vogëlushi 11-vjeçar, ndërroi jetë tre ditë më parë, gjatë një ndërhyrje kirurgjikale në sy, pasi i kishte të ngjitura qepallat e syve dhe nuk mund ta hapte atë që të shikonte normalisht.

## Tritan Shehu:

Kemi ilaçe për komplikimet nga anestezia

Tritan Shehu, profesor dhe kreu i shoqatës së anestezisë-reanimacionit, ka shpjeguar nga ana mjekësore komplikimet e rralla që mund të ndodhin si pasojë e anestezisë. Sipas tij, shkaqet e komplikacioneve nga anestezia, janë të ndryshme, por ajo që ka rëndësi është reanimimi i pacientit që i ndodh një komplikim i tillë. "Ekipi i mjekëve irlandezë ishte shumë i specializuar dhe ata kanë zbatuar të gjithë praktikën mjekësore për të mbajtur në jetë 11-vjeçarin. E megjithatë nuk kanë mundur ta shpëtojnë, pasi i mituri kishte një tendencë gjenetike për të bërë hipertermi, që është një ndërlikim shumë i rëndë i procesit anestetik, me mortalitet të lartë. Parashikimi i këtij ndërlikimi është pothuajse i pamundur. Aktualisht nuk ekziston ndonjë antidot i veçantë specifik, për ta luftuar këtë komplikacion. Medikamente që mund të përdoren janë disa, por gjithmonë me rezultate të dyshimta. Në rastin konkret mjekët kanë përdorur lidokainë që është mjaft specifik, por si ka dhënë efekt", - ka sqaruar kreu i anestezisë, Tritan Shehu.

## Urdhri i Mjekut

# "Faji i ministrisë, ilaçi duhej të ishte në spital"

TRIANE

Por ndryshe nga institucionet e tjera që vetëm kanë shfaqësuar mjekët për vdekjen e 11-vjeçarit, D.A, presidenti i "Urdhrit të Mjekut" të Shqipërisë, Dine Abazaj, i ka drejtuar gishtin e akuzës, ministrisë së Shëndetësisë. Sipas tij, është pikërisht dikasteri i bluzave të bardha, përgjegjësjë, për humbjen e jetës së fëmijës 11-vjeç, gjatë një operacioni plastik në sy. Sipas Din Abazaj, ilaçi që mund t'i shpëtonte jetën fëmijës duhet të ishte në spital dhe mjekët



Dine Abazaj

nuk janë fajtorë. "Medikamenti duhet të ishte në spital. Faji nuk është i mjekëve por i ministrisë që nuk kishte marrë masat për futjen e kësaj ampule. Rasti është një aksident spitalor. Mjekët kanë zbatuar rregullat dhe protokollin për një ndërhyrje. Pavarësisht se për këtë medikament nuk ka kërkesa, ai duhet të ishte i pranishëm në depot e spitalit", - ka shpjeguar Abazaj. Bëhet fjalë pikërisht për medikamentin dantrolen, që në vendin tonë nuk është fare i regjistruar, pasi firmat farmaceutike nuk kanë interes ta sjellin, për shkak se nuk ka fare kërkesa për të.

## QSUT:

# Fëmija vdiq nga hipertermia jo faji i ekipit të mjekëve

TRIANE

Ka reaguar për vdekjen e 11-vjeçarit edhe nëndrejtori i QSUT-së, Besim Boçi. Sipas tij, fëmijët me anomalitë të lindura kongjenitale, hipertermia gjatë ndërhyrjes kirurgjikale është ndërlikim i njohur, por fjalën e fundit do ta thonë mjekësia ligjore e drejtësia. Pacienti 11 vjeçar D.A ka pasur ndërhyrjen e tretë që kryhej nga mjekët irlandezë, ndërsa dy të parat kanë rezultuar të suksesshme. "Pasi fëmijës i janë kryer ekzaminimet e duhura mjekësore është futur në



Besim Boçi

sallën e operacionit dhe ka filluar normalisht ndërhyrja kirurgjikale. Nga mesi i ndërhyrjes fëmija, ka bërë një ndërlikim, i cili mendohet se është si pasojë e lëndëve anestezike të përdorura, duke sjellë një hipertermi malinjë, temperaturë mbi 42 gradë. Fatkeqësisht të gjitha masat e marra nga mjekët irlandezë në bashkëpunim me mjekët tanë, fëmija nuk u riktheje dot në jetë. Ajo që mund të them tashmë si mjek, është që të fëmijët me anomalitë të lindura, o hipertermia malinjë gjatë ndërhyrjes kirurgjikale, njihet në mjekësi", - ka shpjeguar Boçi.



## LSI apel politikës, përgjegjshmëri për integrimin

LSI i bën apel politikës të bashkëpunojë në interes të vendit për marrjen e statusit të vendit kandidat në Bashkimin Europain. Sekretari i Përgjithshëm, Luan Rama, u shpreh se partia e tij, distancohet nga gjuha e përdoruar ditët e fundit nga klasa politike. "Jemi në një moment historik jo vetëm se jemi në virgjilje të 100- vjetorit

të pavarësisë por edhe prej detyrimit që lidhet me angazhimin e prioritetëve që ka Shqipëria në kuadër të procesit të integritimit. Politika duhet të lërë mënjatë gjuhën e vjetër dhe të shfaqet me përgjegjshmëri të plotë në përputhje edhe me mesazhet që vijnë nga BE-ja por edhe nga miqtë ndërkombëtarë që presin nga Shqipëria, nga klasa politike

sjellje dinjitoze në përputhje me interesat europiane të vendit", tha dje sekretari i përgjithshëm i LSI. Ndërkohë që prej ditësh partia në koalicionin mazhoritar vijon që të kërkojë bashkëpunim mes partive politike, në mënyrë të tillë që raportit i KE, që pritet të dalë së shpejti, të jetë pozitiv për integrimin e vendit tonë në BE.

Fqinjët të shqetësuar nga lirimi i të burgosurve shqiptar

# Greket, frikë për amnistinë në Shqipëri

Athina rikujton amnistinë e Ramiz Alisë

■ ■ ■ TIRANE

ARTEMISA HOXHA

## Lajmi

Përfitim i amnistisë nga shumë të burgosur në Shqipëri duket se nuk është një lajm që gëzon vendin fqinj, Greqinë. Mediat greke shprehin shqetësimin dhe frikën e të liruave nga burgjet me rritjen e krimit, grabitjeve dhe vrasjeve nga shqiptarët në vendin e tyre.

Miratimi i amnistisë së propozuar nga qeveria shqiptare me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë, nuk është pritur mirë nga shteti fqinj, Greqia. Forcat e policisë greke e shikojnë këtë amnisti si një rrezik për shtetin e numrit të kriminelëve shqiptarë në vendin e tyre, apo të grabitësve dhe dhunuesve. Sipas faqes on line të lajmeve "smarkos.blogspot.com", që i referohet lajmeve nga Athina, në shtypin grek është shpallur që prej ditës së djeshme kjo frikë nga ata që do të fitojnë lirinë nga burgjet shqiptare në 28 nëntor. "Amnistia në Shqipëri ka shkaktuar

shqetësime me policinë greke lidhur me planifikimin e lirim të 2.094 të burgosur. Kjo, në kuadër të lajmeve me rastin e 100 vjetorit të themelimit të shtetit shqiptar, ku kreu i qeverisë Salë Berisha dha falje për të burgosurit për vepra të ndryshme penale. Kjo, në bazë të "sekreteve" që qarkullojnë dhe pas një raportimi të bërë në një botim që është postuar në shtypin shqiptar", thuhet në

këtë faqe lajmesh. Ndërkohë që më tej sipas lajmeve të shkruara nga shtypi grek në Athinë, shumica e atyre të amnistuarve janë të dënuar me vrasje si dhe trafik droge, ç'ka mund të përbëjë një rrezik për popullin grek nëse ata do të shkojnë drejt vendit fqinj.

## KRAHASIMI ME AMNISTINË E ALISË

Shtypi grek vijon edhe më

tej duke shpallur frikën nga të dënuarit që do fitojnë lirinë në Shqipëri në 28 nëntor, duke i krahasuar ata në shumicën e rasteve edhe me të amnistuarit para 22 viteve nga Ramiz Alia. "Midis tyre janë shumë, të cilët kanë qenë të dënuar për vrasje, trafikim dhe përfshirjen në qarqet e trafikut të drogës dhe të organeve njerëzore! Oficerët grekë kujtojnë ndjenjën se një amnisti e ngjashme u dha para rreth 22 vjet nga qeveria e Ramiz Alisë. Ajo rezultoi se Greqia u mbush



Policia greke

plotë me kriminelë që therrën, grabitën, dhe dhunuan!", vijon më tej lajmi i botuar në këtë faqe on line. Shkrimi përfundon me frikën e grekëve se shumica prej atyre që do të lirohen do të kaljnë kufirin grek. "Të njëjtat burime be-

sojnë se shumica e atyre që do të lirohen do të kalojnë nëpër kufirin grek për të kërkuar sigurinë jashtë këtyre kufijve", thuhet në shtypin e huaj lidhur me amnistinë që miratoi vetëm dy ditë më parë Parlamenti shqiptar.



## REPUBLIKA E SHQIPERISE

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS



Adresa: Bulevardi Dëshmoret e Kombit, 1001 Faqja web: <http://www.mete.gov.al>

## FTESË PËR OFERTË

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energetikës, bazuar në ligjin, nr. 9663, datë 18.12.2006, "Për koncesionet", i ndryshuar, në VKM, nr. 27, datë 19.01.2007, "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", i ndryshuar, në VKM, nr. 584, datë 22.08.2012 "Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Driza" dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë", si dhe në VKM, Nr. 268, datë 18.4.2012 "Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të dhënies së koncesionit", shpall ftesën për pjesëmarrje në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Driza".

- Kërkohe, që projekti të realizohet duke shfrytëzuar urrat e Përroit të Vrisit Peces.
- Ofertuesit e interesuar mund të njihen me dokumentet standarde të procedurës konkurruese në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).
- Ofertuesit të paraqesin vetëm një ofertë, ku të angazhohen se pranojnë kushtet e përcaktuara në ftesën për procedurën konkurruese dhe detyrimet që rrjedhin nga fitimi i procedurës konkurruese.
- Ofertat duhet të shoqërohen me dokumentet ligjore dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara, si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e procedurës konkurruese dhe të ngarkohen në sistemin e prokurimit elektronik të Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Sigurimi i ofertës, që është në shumën 2% të vlerës së Projektit, të dorëzohet së bashku me ofertën. Format e pranueshme të sigurimit janë përshkruar në dokumentet e procedurës konkurruese.
- Asnjë ofertues nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e konkurrimit në bazë të shtetësisë.
- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data .10/12./2012, ora 12:00. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.
- Ofertat do të hapen në mënyrë elektronike pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energetikës, në datën .10/12./2012, ora 12:00.
- Përfaqësues të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.



## REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA DURRES



### HOUSING WITH SOCIAL PROPOSE PROJECT PROJECT IMPLEMENTATION UNIT

CONSULTING SERVICES  
CEB Loan F/P 1580 (2008)  
Expressions of Interest

The Government of Albania has received a loan from the Council of Europe Development Bank (CEB) and intends to apply part of the proceeds of this credit to payments under the contract for Consulting Services "Audit of Social Rental Housing Project for year 2011".

The auditing service includes the following tasks:

- Audit the Project Financial Statements of the Municipal Social Rental Housing Project for period from January 2011 – December 2011.
- Audit the Project Financial Statements (including Statement of Expenditure and Special Account) for the same project;
- The objective of the Projects Financial Statements' auditors, is to analyze the Financial Balance of the project, in accord with the (IAS);
- Audit the Projects' accounting systems (books and records) and provides the basis for the preparation of the special purpose PFS, special-purpose SOEs and special-purpose Statement of SA, and is established to record the financial transactions.

The Project Implementation Unit now invites eligible consultants to indicate their interest in providing the services. Interested consultants must provide information indicating that they are qualified to perform the services: **Similar contract, client references, professional licence, Curriculum Vitae**.

A consultant will be selected in accordance with the procedures set out in the Council of Europe Development Bank (CEB) Procurement Guidelines (November 2004 Version III under a LCS procedure (Least-Cost Selection).

Interested consultants may obtain further information at the address below from Monday till Friday, 9:00-14:00 hrs. Expressions of interest must be delivered to the address below until 26 November 2012 at 10:00 AM

Social Housing Project in Durres  
Project Implementation Unit  
L. Nr. 3, Rr. "Pai Engjëlli",  
Pall. Nr. 8; Kati II  
Durres/Albania Tel : 355 52 221631



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS



Adresa: Bulevardi Dëshmoret e Kombit , 1001 Faqja web: <http://www.mete.gov.al>

## FTESË PËR OFERTË

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, bazuar në ligjin, nr. 9663, datë 18.12.2006, "Për koncesionet", i ndryshuar, në VKM, nr. 27, datë 19.01.2007, "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", i ndryshuar, në VKM, nr. 585, datë 22.08.2012 "Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie me koncesion të hidrocentraleve "Babjen" e "Lozhan2" dhe miratimin e bonusit në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë", si dhe në VKM, Nr. 268, datë 18.4.2012 "Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të dhënies së koncesionit", shpall ftesën për pjesëmarrje në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve "Babjen" e "Lozhan2".

- Kërkohet, që projekti të realizohet në ujërat e rrjedhës së mesme të lumit Devoll.
- Ofertuesit e interesuar mund të njihen me dokumentet standarde të procedurës konkurruese në faqen zyrtare te Agjencisë së Prokurimit Publik: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).
- Ofertuesit të paraqesin vetëm një ofertë, ku të angazhohen se pranojnë kushtet e përcaktuara në ftesën për procedurën konkurruese dhe detyrimet që rrjedhin nga fitimi i procedurës konkurruese.
- Ofertat duhet të shoqërohen me dokumentet ligjore dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara, si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e procedurës konkurruese dhe të ngarkohen në sistemin e prokurimit elektronik të Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Sigurimi i ofertës, që është në shumën 2% të vlerës së Projektit, të dorëzohet së bashku me ofertën. Format e pranueshme të sigurimit janë përshkruar në dokumentet e procedurës konkurruese.
- Asnjë ofertues nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e konkurrimit në bazë të shtetësisë.
- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data 10/12./2012, ora 12:00. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.
- Ofertat do të hapen në mënyrë elektronike pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në datën 10./12./2012, ora 12:00.
- Përfaqësues të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS



Adresa: Bulevardi Dëshmoret e Kombit , 1001 Faqja web: <http://www.mete.gov.al>

## FTESË PËR OFERTË

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, bazuar në ligjin, nr. 9663, datë 18.12.2006, "Për koncesionet", i ndryshuar, në VKM, nr. 27, datë 19.01.2007, "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", i ndryshuar, në VKM, nr. 572, datë 29.08.2012 "Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie me koncesion të hidrocentraleve "Qarr" e "Kaltanj" dhe miratimin e bonusit në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë", si dhe në VKM, Nr. 268, datë 18.4.2012 "Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të dhënies së koncesionit", shpall ftesën për pjesëmarrje në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve "Qarr" e "Kaltanj".

- Kërkohet, që projekti të realizohet në rrjedhën e sipërme të lumit Osum.
- Ofertuesit e interesuar mund të njihen me dokumentet standarde të procedurës konkurruese në faqen zyrtare te Agjencisë së Prokurimit Publik: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).
- Ofertuesit të paraqesin vetëm një ofertë, ku të angazhohen se pranojnë kushtet e përcaktuara në ftesën për procedurën konkurruese dhe detyrimet që rrjedhin nga fitimi i procedurës konkurruese.
- Ofertat duhet të shoqërohen me dokumentet ligjore dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara, si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e procedurës konkurruese dhe të ngarkohen në sistemin e prokurimit elektronik të Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Sigurimi i ofertës, që është në shumën 2% të vlerës së Projektit, të dorëzohet së bashku me ofertën. Format e pranueshme të sigurimit janë përshkruar në dokumentet e procedurës konkurruese.
- Asnjë ofertues nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e konkurrimit në bazë të shtetësisë.
- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data 10/12./2012, ora 12:00. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.
- Ofertat do të hapen në mënyrë elektronike pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në datën 10./12./2012, ora 12:00.
- Përfaqësues të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS



Adresa: Bulevardi Dëshmoret e Kombit , 1001 Faqja web: <http://www.mete.gov.al>

## FTESË PËR OFERTË

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, bazuar në ligjin, nr. 9663, datë 18.12.2006, "Për koncesionet", i ndryshuar, në VKM, nr. 27, datë 19.01.2007, "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", i ndryshuar, në VKM, nr. 582, datë 22.08.2012 "Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie me koncesion të hidrocentralit "Kasollet e Selcës" dhe miratimin e bonusit në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë", si dhe në VKM, Nr. 268, datë 18.4.2012 "Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të dhënies së koncesionit", shpall ftesën për pjesëmarrje në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit "Kasollet e Selcës".

- Kërkohet, që projekti të realizohet në ujërat e lumit Selcë, degë e rrjedhës së mesme të lumit Devoll.
- Ofertuesit e interesuar mund të njihen me dokumentet standarde të procedurës konkurruese në faqen zyrtare te Agjencisë së Prokurimit Publik: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).
- Ofertuesit të paraqesin vetëm një ofertë, ku të angazhohen se pranojnë kushtet e përcaktuara në ftesën për procedurën konkurruese dhe detyrimet që rrjedhin nga fitimi i procedurës konkurruese.
- Ofertat duhet të shoqërohen me dokumentet ligjore dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara, si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e procedurës konkurruese dhe të ngarkohen në sistemin e prokurimit elektronik të Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Sigurimi i ofertës, që është në shumën 2% të vlerës së Projektit, të dorëzohet së bashku me ofertën. Format e pranueshme të sigurimit janë përshkruar në dokumentet e procedurës konkurruese.
- Asnjë ofertues nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e konkurrimit në bazë të shtetësisë.
- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data 10/12./2012, ora 12:00. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.
- Ofertat do të hapen në mënyrë elektronike pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në datën 10./12./2012, ora 12:00.
- Përfaqësues të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS



Adresa: Bulevardi Dëshmoret e Kombit , 1001 Faqja web: <http://www.mete.gov.al>

## FTESË PËR OFERTË

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, bazuar në ligjin, nr. 9663, datë 18.12.2006, "Për koncesionet", i ndryshuar, në VKM, nr. 27, datë 19.01.2007, "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", i ndryshuar, në VKM, nr. 583, datë 22.08.2012 "Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie me koncesion të hidrocentralit "Guri i Kuq" dhe miratimin e bonusit në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë", si dhe në VKM, Nr. 268, datë 18.4.2012 "Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të dhënies së koncesionit", shpall ftesën për pjesëmarrje në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit "Guri i Kuq".

- Kërkohet, që projekti të realizohet duke shfrytëzuar prurjet e përroit të Gostivishtit dhe të Kolloveshit të cilat janë degë e lumit Osum.
- Ofertuesit e interesuar mund të njihen me dokumentet standarde të procedurës konkurruese në faqen zyrtare te Agjencisë së Prokurimit Publik: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).
- Ofertuesit të paraqesin vetëm një ofertë, ku të angazhohen se pranojnë kushtet e përcaktuara në ftesën për procedurën konkurruese dhe detyrimet që rrjedhin nga fitimi i procedurës konkurruese.
- Ofertat duhet të shoqërohen me dokumentet ligjore dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara, si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e procedurës konkurruese dhe të ngarkohen në sistemin e prokurimit elektronik të Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Sigurimi i ofertës, që është në shumën 2% të vlerës së Projektit, të dorëzohet së bashku me ofertën. Format e pranueshme të sigurimit janë përshkruar në dokumentet e procedurës konkurruese.
- Asnjë ofertues nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e konkurrimit në bazë të shtetësisë.
- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data 10/12./2012, ora 12:00. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.
- Ofertat do të hapen në mënyrë elektronike pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në datën 10./12./2012, ora 12:00.
- Përfaqësues të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.



EKONOMI

**PS: Fasonistët nën arbitraritetin e pushtetit, ne partnerë**

Nisma e pushtetit të Sali Berishës për të pesëfishuar gjatë edhe kundrejt industrisë së fasonit vjen në një moment tepër kritik për këtë sektor jetik për punësimin, ka deklaruar dje sekretari i PS për Programin, Ilir Beqja. Sipas tij, sektori përballat me një rënie të xhiros 24% krahasuar me 2011 dhe në 10 muaj janë pakësuar 25.000 vende pune. Ky sektor, me


eksperiencë 20-vjeçare, është i diskriminuar pasi përjashtohet nga mundësia e kontratave me para publike. Tani qeveria synon t'i nënshtrojë fasonistët nën dhunën arbitrarë të përditshme të doganllarëve dhe tatimllarëve, të cilët muajt e fundit janë turrur të vënë më shumë gjoba sesa ka biznese në vend, tha ai. E gjitha kjo për të rimbushur arkat e shtetit, të zbrazura

prej papërgjegjshmërisë kriminale dhe korrupsionit të oborrit të pushtetit të Sali Berishës. Partia Socialiste përsëriti angazhimin për të qenë partner i këtij sektori thelbësor për ekonominë e vendit, duke hequr detyrimet për importin e makinerive pa asnjë kufizim, për të gjetur tregje të rinj e për nxitur punësimin dhe prodhimin vendas.

Financat deklarojnë 59.8%, por me një PBB më të lartë

# Borxhi publik kalon mbi 60 për qind

Italia, kreditori më i madh i Shqipërisë



Mbajtësit e borxhit të brendshëm të shtetit shqiptar

Lajmi

**Borxhi publik shqiptar ka kaluar mbi nivelin e 60 përqindëve të Prodhimit të Brendshëm Bruto, ndonëse zyrtarisht pranohet një shifër 59.8%. Bankat zotërojnë më shumë se gjysmën e bonove të thesarit, ndërkohë që si shtet kreditori më i madh është Italia**

GENC KONDI

Financuesit e borxhit të jashtëm publik të Shqipërisë (në milionë euro)

Sipas kreditorëve	Deri në 31.12.2007	2008	2009	2010	2011	3M 2012	6M 2012	9M 2012	TOTALI
AUSTRIA	4.51	-	5.03	2.46	6.35	5.01	0.51	4.08	27.94
BULLGARI	0.08	-	-	-	-	-	-	-	0.08
ÇEKI	8.49	-	-	-	-	-	-	-	8.49
GREQI	40.54	-	-	-	-	-	-	-	40.54
GJERMANI	78.63	6.08	5.80	9.16	13.14	2.79	1.36	2.48	119.44
HUNGARI	11.52	-	-	-	-	-	-	-	11.52
ITALI	94.43	15.95	23.24	39.08	26.80	1.78	12.43	2.61	216.33
JAPONI	18.15	-	-	2.29	1.32	0.15	0.24	0.52	20.67
JUGOSLLAVI	0.05	-	-	-	-	-	-	-	0.05
MAGEDONI	0.98	-	-	-	-	-	-	-	0.98
TURQI	28.86	-	-	-	-	-	-	-	28.86
KUVAJTI	39.13	3.04	2.46	2.50	0.83	1.14	0.45	1.52	51.08
RINI	41.09	-	-	-	-	-	-	-	41.09
POLONI	0.92	-	-	-	-	-	-	-	0.92
RUMANI	4.50	-	-	-	-	-	-	-	4.50
SPANJE	0.96	0.74	5.02	-	-	-	-	-	6.71
SLOVAKI	4.30	-	-	-	-	-	-	-	4.30
SUEDI	3.14	-	-	-	-	-	-	-	3.14
NORVEGJI	28.86	-	-	-	-	-	-	-	28.86
ARABIA SAUDITE	-	-	-	-	0.80	1.07	0.10	0.007	1.87
HOLLANDE	-	4.40	5.90	1.72	0.40	-	-	-	12.43
RUSIA	0.73	-	-	-	-	-	0.009	-	0.73
SERBIA	5.93	-	-	-	-	-	-	-	5.93
ZVICRA	4.47	-	-	-	-	-	-	-	4.47
MALI I ZI	0.43	-	-	-	-	-	-	-	0.43
KROACIA	4.47	-	-	-	-	-	-	-	4.47
SLOVENIA	2.91	-	-	-	-	-	-	-	2.91
BOSNIA-HERCEGOVINA	2.82	-	-	-	-	-	-	-	2.82

**BORXHI I JASHTËM**

Ndërkohë, Italia është kreditori më i madh i Shqipërisë si shtet, me kredi dy-palëshe, me shifrën 269 milionë euro aktualisht. Pas saj, vend Gjermania me 201 milionë euro, ndërkohë që vendin e tretë e të katër e ndajnë Japonia dhe Kuvajti, shumë më poshtë së kaq, me 57 dhe 51 milionë euro.

Ndër institucionet ndërkombëtare, i kanë dhënë më shumë borxh Shqipërisë degët e Bankës Botërore, të pasuara nga bankat e Bashkimit Evropian.

Vitet e fundit, gjithnjë e më shumë përfaqëues të institucioneve si FMN apo BB kanë bërë thirrje që qeveria të ulë nivelin e borxhit publik ndjeshëm, pasi një ekonomi si ajo shqiptare mund të rrezikohet seriozisht me 60% borxh, ndërkohë që një ekonomi e fuqishme nuk ndjehet e rrezikuar nga nja nivel i tilla, madje edhe më i lartë se kaq, pasi ka mundësitë për t'i shlyer lehtësisht. Një këshillë e tillë nuk është marrë parasysh nga ana e Ekzekutivit, i cili duket se nuk është në gjendje të ulë borxhin dhe sytë po i mban tek privatizimet, si një gomë shpëtimi për "gjinahet" e buxhetit.

Borxhi publik mbërriti në tremujorin e tretë sipas të dhënave të ministrisë së Financave ndodhet shumë pranë kufirit ligjor të 60 përqind të Prodhimit të Brendshëm Bruto, në pikën 59.8 përqind. Por, llogaritjet tjera tregojnë se ky kufi ligjor praktikisht është shkelur.

Sipas qeverisë, në fund të shtatorit detyrimet e shtetit shqiptar arritën në 81.3 miliardë lekë ose rreth 8.1 miliardë dollarë, duke u rritur me rreth 350 milionë dollarë të tjerë nga fundi i vitit të kaluar, pavarësisht politikës së deklaruar të shtrënguar buxhetore të qeverisë, përmes kurrjes së investimeve apo disa zëra të tjerë në shpenzime. Në nëntë muajt e këtij viti, borxhi u rrit me 0.45 pikë përqindje ndaj PBB-së, ndërsa krahasuar me vitin 2010 rritja është rreth 1.3 pikë përqindje.

LLOGARITJA

Këto janë shifrat zyrtare të vetë qeverisë, ndërkohë që institucionet ndërkombëtare paralajmërojnë se shifra reale është më e madhe. Vetëm pak ditë më parë Banka Botërore tha se detyrimet e fshehura të buxhetit ndaj privatëve mund të jenë nga 1.5 deri në 2 përqind e prodhimit bruto, çka do të thotë se edhe pse jo zyrtarisht, 'de facto' borxhi i qeverisë shqiptare e ka kapërcyer kufirin ligjor prej 60 përqind.

Por, gjithshka fshihet edhe në llogaritjet që i bëhet Prodhimit të Brendshëm Bruto.

Ministria e Financave llogarit për këtë vit një PBB 4.5 përqind më të lartë se ajo që është realizuar vitin e kaluar, meqenëse një gjë të tillë e ka deklaruar vjet kryeministri Berisha. Në fakt, sipas INSTAT-it ky PBB është rritur 2 përqind dhe, në këtë rast, raportit i borxhit publik me të është më i madh se 61 përqind. Ndërkohë, po të merret për bazë rritja e parashkuar nga institucione ndërkombëtare të tilla si Banka Botërore APO Fondi Monetar Ndërkombëtar, rritja ekonomike e Shqipërisë duhet të përfshihet midis shif

rave 0.5 dhe 1 përqind, duke bërë që raportit të përkeqësohet edhe më tej. Në rastin e PBB-së me rritje vetëm 0.5 përqind, të parashkuar nga FMN-ja, borxhi publik afrohet me 63 përqind, sipas shifrës të parqitur nga ministria e Financave për këtë borxh.

**BORXHI I BRENDSHËM**

Vitet e fundit qeveria shqiptare është përpjekur që, për të zbutur kostot e borxhit, të ndryshojë strukturën e tij, duke zëvendësuar borxhin e brendshëm afatsh-

kurtër me kredi me afat më të gjatë maturimi nga jashtë. Si pasojë e kësaj strategjie borxhi i jashtëm është rritur nga 1.45 miliardë dollarë në fund të vitit 2006 në 3.57 miliardë në fund të 9-mujorit të këtij viti. Ndërsa në raport me PBB-në rritja është mbi 10 pikë përqindje dhe, për herë të parë, në fund të shtatorit pjesa më e madhe e tij ishte borxh tregtar.

Mbajtësit e borxhit të brendshëm të shtetit shqiptar janë kryesisht bankat e nivelit të dytë, por ndërkohë në vitë është rritur ndjeshëm pjesa e qyteta-

rëve, të cilët kanë blerë obligacione afatgjata dhe bono thesari nga tre deri në 12-mujore në masën 15.66 përqind të borxhit të brendshëm, nga 8.33 përqind që ishte ky raport në fund të vitit 2008. Bankat zotërojnë më se 60 përqind të letrave me vlerë të qeverisë, ndërkohë që Banka e Shqipërisë ka ulur pjesëmarrjen e saj në blerje të borxhit të brendshëm. Banka Raiffeisen, që ka qenë blerësi më i madh i bonove, ka kaluar nga 37% e totalit në 29 përqind të portofolit të përgjithshëm të tyre, si pasojë e një politike largimi nga borxhi publik shqiptar.

**Energjia**

# Haxhinasto: CEZ shkeli kontratën

GENC KONDI

Marrëdhënia me kompaninë CEZ Shpërndarje është problematike, pasi kjo kompani nuk ka zbatuar disa pika të kontratës, si në rastin e ndërprerjes kolektive të energjisë", deklaroi Edmond Haxhinasto, zv.kryeministër dhe ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Deklarata e tij u bë në përfundim të konferencës ministeriale "Evropa Juglindore-2020 Drejt Konvergencës dhe Rritjes", ku merrnin pjesë ministrit e Ekonomisë të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Haxhinasto tha se, pavarësisht marrëdhënies me kompaninë CEZ, kon-



Edmond Haxhinasto

sumatorëve do t'u sigurohet furnizimi me energji elektrike pa ndërprerje. Sipas tij, po merren masa që qytetarët shqiptarë të kenë shpërndarje cilësore dhe të sigurt të energjisë, edhe nëse ky shërbim do të kontrollohet nga shtetit apo nga një kompani tjetër private. Aktiviteti i kompanisë çeke që ka privatizuar prej disa vitesh sistemin e shpërndarjes, tha Haxhinasto, është nën monitorimin e institucioneve qeveritare.

Kreu i METE-s bëri të ditur se ndërprerjet kolektive janë të paligjshme dhe si të tilla do të penalizohen nga Enti Rregullator i Energjisë. "Çdo konsumator duhet të trajtohet në bazë të kontratës individuale që ka me ko-

mpaninë", tha Haxhinasto. Ai bëri të ditur se "jemi ende në proces bisedimesh me kompaninë CEZ".

Duke iu përgjigjur interesit të medias, Haxhinasto bëri të ditur se privatizimi i Alpetrolit do të finalizohet brenda vitit 2012. Sipas tij, procedurat deri në përfundimin e kontratës janë brenda afateve. Në lidhje me garancinë prej 20 përqind që kompania fituese duhet të ngrijë për llogaritje të qeverisë shqiptare, kreu i Ekonomisë tha se sipas ligjit ajo mbyllet kur të nënshkruhet kontrata. "Ky 20 përqindsh ngurtësohet në momentin që përfundon kontrata dhe kjo është e kërkuar në mënyrë shumë të qartë nga ligji", u shpreh ai.



**LINDA HALIMI**  
LE PA FJALE TRE  
ZONJA TE POLITIKES



**MISS GLOBE**  
PREZANTOJNE KRENAR  
AHMETI & HYGERTA SAKO

WWW.SHQIPTARJA.COM

Suplementi i së shtunës te SHQIPTARJA.com

# THASH&THEM

NR. 40 E shtunë, 10-11-2012

E-mail: thashethem@shqiptarja.com



**VALBONA  
MEMA**

DOBESOHET, SUKSESI  
I ANILA KALLESHTIT



**EKSKLUZIVE**  
FOTOT E  
PAPARACIT



**ENADA  
AT'NIKOLLA**

Arsyet pse i thashë  
jo revistës "Elle"



**DISLIKE NE  
YOUTUBE**

Big Basta: Më  
frymëzojnë për  
tekstet e radhës



**KENGA MAGJIKE**

KUSH DO TA RREMBEJE  
TROFEUN E KETIJ EDICIONI




**ADROLA  
DUSHI**

Unë çapkënia  
që fitova "Miss  
Universe Albania"



**GAZETARJA  
E AI REPORT**

OLA BRUKO NENE  
PER HERE TE DYTE  
VJEN NE JETE KLOI



**DAFINA ZEQIRI**  
SEKSI DHE SENSUALE  
PER FADIL BERISHEN

**BAMIR TOPI**  
**ARTISTET QE MBESHTESIN  
ISH PRESIDENTIN**  
NE KRAHË TË TIJ 75-VJEÇARI TONIN TËRSHANA

**BAMIR TOPI**

# Ja artistët që mbështesin ish-Presidentin

Në krahë tij Tonin Tërshana



Ish-Presidenti Bamir Topi dhe njëkohësisht kryetari i partisë Fryma e Re Demokratike, Bamir Topi duket se ka mbështetjen e plotë të artistëve shkodranë. Ai ka qenë i ftuar në ceremoninë familjare të peshëngritësit, Faruk Kalleshi i cili është nderuar me çmimin "Nderi i kombit". Por shohim që Topi është rrethuar edhe nga emra të njohur të muzikës shqiptare, që duket se kanë mbështetur ish-presidentin. Bujar Qamili, Tonin Tërshana, Valbona Mema, por edhe ish peshëngritësi Faruk Kalleshi kanë qenë pranë Topit. Së bashku me bashkëpunëtorin e tij të ngushtë, Gazmend Oketa Topi duket mjaft i kënaqur, në këtë atmosferë mes artistëve. I veshur jo mjaft seriozë, por jo dhe shumë sportivë, ish-Presidenti dhe njëkohësisht kryetari i FRPD-

së, Bamir Topi, ka në duar edhe flamurin kombëtar, duke mos anashkaluar edhe në këtë ceremoni mes miqsh, 100 vjetorin e pavarësisë që është bërë refereni kryesor i të gjithë politikanëve, e artistëve në këtë periudhë. Në një tjetër fotografi shohim se Bamir Topi, ka mbajtur një fjalim për z. Kalleshi duke evidencuar vlerat dhe kontributin që ai ka dhënë në sportin shqiptar. Të dy politikanët kanë qenë në Shkodër dy ditë përpara se kryetarja e Parlamentit, Jozefina Topalli të sfidonte, Sekretarin e përgjithshëm të FRPD-së, Gazmend Oketa duke i kujtuar atij se kishte lidhje me Partinë e Punës. Ndaj dhe të dy politikanët shfaqen përkrahë artistëve shkodranë duke i bërë karshillëk, kryetares së Parlamentit e cila e mendon si domën të vet qytetin e Shkodrës.



## TONIN TERSHANA

### 75-vjeçari shfaqet për herë të parë në publik

I kishte munguar prej kohësh skenës shqiptare dhe ja tek e shohim me mes miqëve dhe artistëve, këngëtarin e mirënjohur Tonin Tërshana. Ndonëse është 75 vjeç Tërshana, nuk ngurron të gjendet pranë miqëve të tij artistë. Ai ka qenë i pranishëm në drekën që ka organizuar ish-peshëngritësi, Faruk Kalleshi. Legjenda e muzikës sh-

qiptare, ka kënduar së bashku me këngëtarin e muzikës popullore, Bujar Qamili, duke dhuruar emocione të veçanta për të pranishmit. Në këtë ceremoni ka qenë i pranishëm edhe ish-Presidenti Bamir Topi dhe ish-deputeti i PD-së, Gazmend Oketa. Dy politikanët duket se janë shumë miqësor dhe të afërt me artistin e madh të skenës shqiptare.



## KENGETARJA

### Dobësohet Valbona Mema, sukcesi i Anila Kalleshit

Këngëtarja e muzikës popullore, Valbona Mema ka humbur shumë kile nga pesha e saj trupore. Këngëtarja duket shumë mirë dhe çelësi i suksesit të saj, është qëndra e dobësimit "Kalleshi", aty ku janë drejtuar shumë nga personazhet pub-

like shqiptare. Zëri i ëmbël i muzikës popullore të Shqipërisë së Mesme, Valbona Mema ka kënduar në një ambient mes miqsh dhe artistësh dhe ka dhuruar emocion për të pranishmit. Ajo është kujdesur shumë edhe për veshjen e saj, duke u kombinuar mjaft mirë.

## MISS GLOBE

### Prezantojnë Krenar Ahmeti dhe Hygerta Sako

E shtuna e 10 nëntorit do të jetë mbremja finale e edicionit të 39-të të "Miss Globe". Konkurrentet e këtij viti tanimë kanë zbkruar në Vlorë, qytet në të cilin Petri Bozo vendosi të organizonte, për të nëntin vit në Shqipëri, garën ndërkombëtare të bukurisë. Nata finale është në prag dhe mes 43 konkurrenteve ndihen ethet e

garës. Vetëm njëra prej tyre do të fitojë kuroren e më të bukurës së Globit. Ditët e fundit kanë qenë të ngarkuara për këto bukuroshe që kanë bujtur sivjet në Shqipëri. Vajzat sfilojnë, punojnë me ko-reografen Olta Ahmetaj, nën tingujt muzikorë të përzgjedhur nga Fabian Basha, ushtrijnë performancat, provojnë veshjet. Vëmendja është



zhvendosur në finalen e spektaklit që do të mbahet në Pallatin e Sportit të qytetit të Vlorës. Dy prezantuesit, Krenar Ahmeti dhe Hygerta Sako,

janë përshtatur me skenën dhe me njëri-tjetrin, këmbëjnë batuta dhe diskutojnë detajet e fundit të skaletës. Në këtë festë të bukurisë,

sigurisht nuk do të mungojnë edhe elementet festive të këtij viti jubilar për shqiptarët. Fashat e secilës prej vajzave janë zbkruar edhe me logon e 100 vjetorit, shqiponjën dy krenare. Rona Nishliu dhe Ardian Lika do të interpretojnë madhërisht në skenë, bashkë me vajzat pjesëmarrëse këngën "Dua më shumë Shqipërinë", ndërsa Aurela Gaçe do të jetë me zërin e saj potent, siç janë ftuar edhe këngëtarë nga të gjitha trevat shqiptare: Hana Cakuli, Agim Poshka etj. Në fund mbretëresha në fuqi e këtij viti, gjermania Stephani Alice, do t'i dorëzojë kuroren një tjetër bukurosheje që pritet të përzgjidhet. Në edicionin e këtij viti Shqipëria prezantohet me Kleoniki Delijorgjin.

**ADROLA DUSHI:**

# Unë çapkënia që fitova "Miss Universe Albania"

Më e bukura e Shqipërisë ëndërron që një ditë të bëhet arkitekte

SUADA DACI

Adrola Dushi vajza 22-vjeçare nga Rrësheni u kurorëzua si më e bukura e Shqipërisë për vitin 2012. Bukuroshja, e cila do të përfaqësojë Shqipërinë në Miss Universe në Las Vegas shprehet plot emocione dhe ndjen përgjegjësinë që ky event përfaqëson. Në një intervistë për suplementin "THASH&THEM" Dushi rrëfen hap pas hapi përjetimet në konkursin "Miss Albania" dhe "Miss Universe Albania" si dhe dëshirat dhe ëndrrat e 22-vjeçares nga Rrësheni. Adrola na ngjan pak me modelen e njohur Naomi Campbell, e në fakt nuk është çudi që është edhe modeli që e frymëzon më shumë.

**Adrola, shpalleni "Miss Universe Albania", mes shumë vajzave të tjera të bukura, çdo të thotë ky çmim për ju?**

Sigurisht që mbi të gjitha është një privilegj i madh të jem qoftë edhe për një vit vajza më e bukur e Shqipërisë, gjë që më jep mundësinë të përfaqësoj vendin tim në konkurse ndërkombëtare.

**Kurora e bukurisë këtë herë shkon në Rrëshen, si ju pritën në qytetin tuaj?**

Ishte një emocion më vete edhe mikpritja që pata në qytetin tim, njerëz pa fund, të cilët njerëzit më përsërisnin një fjali që më shumë se çdo gjë tjetër të bën të ndihesh mirë: "Adrola jemi krenar për ty!"

**Sa e keni ndjerë konkurrencën mes vajzave të tjera konkurrencte?**

Ishte një konkurrencë shumë e fortë, pasi të gjitha vajzat ishin shumë të bukura në mënyrën e tyre të të qenit, dhe çdo gjë e veçantë që kishin si në fizik, ashtu edhe në personalitetin i bënte ato konkurrencte të denja për titullin e më të bukurës së Shqipërisë.

**E mendoni që do të shpallëshit ju fituesja e këtij eventi bukurie?**

E përmenda pak më lartë faktin që konkurrenca në "Miss Albania" ishte tepër e fortë, kjo e bënte çdo konkurrencte një fituese të mundshme, kështu që nuk do ta kisha besuar se në 20 bukurroshe do të isha unë ajo që do të merrte një kurorë



Në foto: Adrola Dushi modelja që fitoi Miss Universe Albania

në fund.

**Do të përfaqësoni Shqipërinë në Miss Universe në Las Vegas, sa i druheni konkurrencës atje?**

Atje është një përgjegjësi e shumëfishit, sepse shkoj duke pasur mbi supë emrin "Shqipëri", nuk do doja të flisja për konkurrencë, thjesht uroj të paraqitem sa më mirë.

**Keni menduar ta ndryshoni pamjen për këtë event?**

Personalisht jo, por edhe nëse ndodh një ndryshim në look-un tim, sërish do të ndihesha e qetë, sepse jam në duar profesionistesh.

**Çfarë është e bukura për ju?**

Çdo gjë që qëndron në brendësinë e njeriut dhe në momentin e parë, që materializohet i lumturon njerëzit që ka përreth.

**Jeni përzgjedhur nga një juri profesioniste, si ju bën të ndiheni ky fakt?**

Sigurisht që më bën të ndihem mirë dhe e vlerësuar.

**E keni ndjekur më parë Miss Albanian dhe e keni pasur një miss të preferuar?**

Të tregohem e sinqertë nuk e kam ndjekur rregullisht (si natyrë çapkëne dhe gati prej djali, nuk e kam parë veten ngushtësisht të lidhur me konkuret e bukurisë), por me pjesëmarrjen tek "Miss Albania" pata fatin të njihja personalisht një vajzë të mrekullueshme, që sot e kam dhe mike, Miss Arnita Beqiraj.

**Keni një modele që ju frymëzon?**


Naomi Campbell.

**Çfarë do të kujtoni nga kjo eksperiencë?**

Çdo gjë që ka ndodhur në këtë periudhë, që nga dita e parë kur kanë nisur provat dhe deri në momentin e kurorëzimit. Një eksperiencë e paharrueshme e cila do të mbetet gjithmonë në mendjen time si mënyra më e bukur për të përshkruar një periudhë të jetës sime.

**Krijuat miqësi në Miss Albania?**

Sigurisht që po, ndër të tjera kjo është diçka të cilën do ta ruaj dhe



kujtoj më shumë dashuri.

**Ç'mendim keni për konkurrencën meshkuj?**

Gjithashtu edhe ndërmjet tyre kishte konkurrencë të fortë, i uroj më të mirat Geraldos, djalin që fitoi.

**Do ta vazhdoni rrugën tuaj drejt modelimit?**

Është herët për të thënë në qoftë se do të vazhdoj një karriere si modele ose jo, për momentin, shqetësimi im kryesor është përfaqësimi sa më dinjitoz i vendit tim. Pas konkursit të "Miss Universe" besoj se gjërat do të jenë më të qarta edhe në aspektin e karrierës së modele.

**Përveç modës, çfarë ju pëlqen tjetër?**

Pas kësaj arkitektura është e ardhna ime në planin afatgjatë.

**Sa ju mbështeti familja në këtë eksperiencë tuajën?**

Ata ishin mbështetja ime kryesore dhe pika ime e fortë. I dua dhe i falenderoj shumë për këtë fakt.

**Ëndrra juaj më e madhe..**

Unë besoj tek fundet e lumtura dhe tek shprehja "Jetuan përgjithmonë të lumtur!" Ëndrra ime është që edhe jeta ime të përfundojë me këtë shprehje, një familje e lumtur dhe e shëndetshme është qëllimi im kryesor.



**Çdo të premtë** Lounge Bar, me çmime 200L Lounge Drink,  
**Çdo të shtunë** Karaoke Night me Kelly, Elerina dhe Graciela  
**Çdo ditë** një menu e pasur me gatime shtëpiake dhe Italiane.  
**Çdo ditë** Menu ofertë 500L-ku është e përfshirë një pjatë e parë, pjatë mishi ose gatime shtëpiake, dhe një pjaje.

Catering të shpejtë në shtëpinë tuaj

**RRUGA "MUSTAFA MATOHTI",  
PËRBALLË PALLATIT ME BIRRILA**

**Cel. 0696070651**

## XHULIA KARAVELLA

Stilistja e njohur Enada At'Nikolla ndonëse shpeshherë zgjedh të qëndrojë larg mediave, vjen në një rrëfim të gjatë dhe të ngrohtë për suplementin "THASH&THEM". Ajo ka qenë pjesë e eventit "Miss Albania" ku luante dy role, atë të stilistes dhe anëtares së jurisë. Gjithashtu Enada na tregon më shumë rreth jetës së saj të përditshme, ëndërrat, puna në atelie dhe rolin si nënë. Një rrëfim ndryshe i sjellë nga At'Nikolla

**Enada në kompeticionin "Miss Albania" erdhët me dy funksione atë të stilistes të veshjeve të konkurrentëve si dhe të jurisë. Si u gjendët në këto dy funksione dhe a ndjetë vështirësi?**

Prioriteti për mua në këtë event ishte qenia ime si stiliste dhe sigurisht që mbante edhe peshën kryesore. Duke qenë se të jepet mundësia të punosh nga afër me konkurrentët të sho-hësh trupat, tiparet dhe natyrat, puna e jurisë bëhet më e lehtë, madje je edhe më e qartë për të përcaktuar fituesen. E gjithë vëmendja ime ishte aty edhe kur isha në juri shihja veten tek kontrolloja ekranet sesi ato shfaqeshin jo vetëm në skenë apo pasarelë. Por dua të theksoj se do të kisha patur më shumë dëshirë të qëndroja pas kuintave për të përcjellë konkurrentët, ashtu siç duhet të qëndrojnë stilisti. E veshur në mënyrë të rehatshme duke i përcjellë konkurrentet. Megjithatë kam një staf të mirë kështu që isha e bindur që gjërat do të shkonin në mënyrën më të mirë të mundshme. Më tëpër e shihja këtë event si sfilatë sesa si konkurs.

**E patët të vështirë të përzgjidhni fituesit?**

Duke qenë edhe në rolin e stilistes unë mund të mendoja dy ose tre variante për çmim por ishte vetëm një ose dy dhe kjo më bënte të ndihesa edhe keq. Edhe pse për konkurrentët rëndësi kishte çmimi, unë e shihja më shumë si sfilatë. Madje u thoja shpesh se nëse do të zhvilloja një sfilatë tani së afërmi ata do të ishin modelët që do të merrja, pasi i shihja si modelë profesionistë. Madje edhe formati i programit ishte i tillë që ato u trajtuan si modele. Mundësia për të dhënë një çmim ose dy e prish festën, ndërkohe që unë atë event e shihja si një festë më të madhe se aq.

**U ndjetë komode me anëtarët e tjerë të jurisë?**

Shumë dhe sidomos me Fadilin, pasi duke qenë të dy të fushës së modës i shohim gjërat me të njëjtin sy. Kemi gati të njëjtin gusto për figurat, fizikun, prerjet e fytyrave. Për çdo gjë binim dakort.

**Do të kemi së shpejti sfilatë nga ju?**

Përpuna se të zhvillonim misin doja të realizoja diçka në dimër. Duke qenë se unë nuk jam prodhuese nuk më duhet të punoj për sfilatën një vit përpara. Ashtu siç i nevojitet klientit dhe siç është praktikë tek unë mund të nis realizimet për sfilatë dy ose tre muaj përpara, pasi punoj me kopie unike, si dhe me numër të caktuar klientësh. Kisha në plan një sfilatë të tillë, përgjithësisht me veshje e përditshme dimërore dhe me disa kopje fustanesh të rëndë, pasi këtë vit ka ballo në kuadër të 100-vjetorit. Në këtë periudhë duhen fustane të tillë. Do të kisha realizuar një përzierje të tyre. Për momentin dua të pushoj, edhe pse është




Më foto: Enada At'Nikolla, foto nga Geljan Kaleci

ENADA AT'NIKOLLA

# Arsyet pse i thashë jo revistës "Elle"

Më pëlqen të luaj me lukun tim, barometri më i mirë



Vajzat shqiptare e ndjekin goxha megjithatë mënyra sesi e ndjekin është gati në sakrificë. Kjo më bën të ndihem mirë edhe keq njëkohësisht. Mirë për interesin që ato kanë ndaj e fushës dhe keq prej pamundësisë

fjalëve kjo ka qenë mënyra ime.

**Cilat janë sipas jush tendencat më të fundit?**

Pavarësisht tendecave dhe prurjeve nga stilistët e tjerë, ajo çka unë vetë kam dëshirë të ndaloj është tek materiali i lëkurës, sidomos në disa funde me rrudha të fryrë, edhe tek materiali i stofit, jo një stof i thjeshtë por që ka pakthurje edhe pak ar brenda tij, pra "ricamato". Copat që i kemi parë në xhaketa e në pallto i shoh në veshje më praktike. Është diçka midis një baroku dhe romanticizmi shumë praktik. Në jetën e përditshme veshja duhet të thotë diçka për njeriun që e mban, pra do të doja që veshja të rëndojë në mënyrë të lehtë. Më pëlqejnë pulovra dhe këmbisha me të qëndisura, dhe që pjesa e sipërme të jetë e punuar por me modele të thjeshta. Edhe xhakatat e kadifes dhe materiali i kadifes lishio është një material që ndjej që më frymëzon dhe në atelie aktualisht po punohet më. Është duke u punuar si në veshjen për meshkuj ashu edhe për femra por edhe më të gjëra e kam frymëzimin për femrat. Më pëlqejnë fundet xhakatat por edhe pulovrat siç i kemi parë

me material kashmiri apo të derdhur unë e shoh me kadifë por me pak viskoze dhe fustane të shkurtër por jo detyrimisht të ngushtë. Por edhe stofin "ricamato" me këto të treja unë nuk do të qëndrojë pa kombinuar "picon" tylin, e shoh si materialin shoqërues të këtyre të trejave. Gjithashtu më pëlqen edhe përdorimi i kopsave, jo me shumicë një ose dy kopsa tek xhakët, por të thotë diçka të flasë shumë, më një të mbështyer të pakët të kryejë edhe funksionin e dhe të flasë. Kjo të vijë e kombinuar me geta në formë pico e bërë rrjetë si merimangë, një picoje të një toni pak më praktik ku edhe nëpër getë të kesh pico. Këto materiale me këto lloj getash dhe me këpucë gjysëm të hapura, më vjen më e fortë sesa me çizme. Por ajo që më pëlqen përjetësisht janë çizmet e kadifes. Megjithatë është vërtetë lluks, mund të alternohen edhe me çizme më praktike por kombinimi më i mirë i mundshëm që propozoj është ky. Këto desha t'i propozoj edhe për ato që nuk kanë kontakt me mua, përveç klientëve të mi.

**Sipas jush vajzat shqiptare sa e ndjekin modën?**

E ndjekin goxha megjithatë mënyra sesi e ndjekin është gati në sakrificë. Kjo më bën të ndihem mirë edhe keq njëkohësisht. Mirë për interesin që ato kanë ndaj e fushës dhe keq prej pamundësisë. Me të vërtetë dyjzohesh pasi gjërat që pelqejmë kushtojmë dhe dëshira ekziston por mundësia jo edhe aq Megjithatë e ndjekin modën dhe janë të vëmendshme ndaj saj.

**Ju mungon modelimi?**

Jo nuk mungon në fakt ka qenë një pasion i imi i hershëm që e kam zëvendësuar shumë





## DAFINA ZEQIRI

### Seksi dhe sensuale për Fadil Berishën

Objektivit të fotografit shqiptar Fadil Berisha, nuk mund ti mungonte as bukurshja kosovare Dafina Zeqiri. Duffy, e cila ndodhet prej disa kohësh në New York, ka vendosur të bëjë disa fotografi të reja, ku vjen shumë sensuale dhe seksi. Vihet re se

këngëtarja ka një ngjashmëri shumë të madhe edhe me këngëtares, nga Barbados Rihanna prej të cilës ka huazuar edhe modelin e flokëve. Nuk e dimë nëse Dafina po përgatit edhe ndonjë këngë të re, pasi në SHBA, ajo realizoi edhe klipin e saj të famshëm "Tonight".

## GAZETARJA A1 REPORT

### Ola Bruko nënë për herë të dytë, vjen në jetë Kloj

Gazetarja simpatike e televizionit A1 Report, Ola Bruko ka sjellë në jetë mbrëmjen e 7 nëntorit vajzën e saj. Vogëlushja, e cila erdhi nëpërmjet një lindje natyrale quhet Kloj dhe peshon 4.1 kg. Mësohet se Bruko është shtruar në maternitetin "Koço Gliozheni" në Tiranë rreth orës 22:00 të mbrëmjes. Gjithashtu Ola ka ndarë këtë gëzim edhe me miqtë e saj në rrjetin social Facebook nëpërmjet një publikimi: "Në orën 22 të

mbrëmjes së 7 nëntorit familjes sonë iu shtua anetari i 4-të. Kloj, një vajzë bukurorshë erdhi në jetë nga një lindje natyrale dhe gëzon shëndet të plotë. Lumturia që ndjejmë unë dhe Andi qenka vërtet magjike sidomos kur shohim Klestin tonë të dashur tek përkedhelë motrën e tij",- ka shkruar gazetarja. Ne të THASH & THEM i urojmë vogëlushes Kloj dhe prindërve të saj një jetë sa më të gjatë e të mbushur me lumturi.



## ANJEZA SHAHINI

### Fanse e çmendur e Obamës

Presidentit Barack Obama, duket se i është shtuar edhe një tjetër mbështetëse dhe


kjo është këngëtarja, Anjeza Shahini. Pas fitores së Presidentit të SHBA-së, Shahini ka postuar në Facebook një fotografi me flamurin e Amerikës. Aшту siç shumë shqiptar, edhe ajo është një fanse e Presidentit Obama.



## VESA & AURELA

### Bjonde, por jo rivale

Janë të dyja bjonde dhe zëra të njohur të muzikës së lehtë shqiptare, por mesa duket janë edhe mikeshatë të mira. Në këtë fotografi shohim dy këngëtares Vesa Luma dhe Aurela Gaçe, teksa kërcëjnë një koncert në Zvicër. Të dyja këngëtares dukën edhe në formë të mirë fizike. Vesa duket shumë elegante me fustanin e saj ngjyrë blu, që nxjerr në pah huret e këngëtares, por në të njëjtën kohë edhe Aurela nuk mbetet pas. Këngëtarja ka humbur shumë kile, që pas lindjes së vajzës së saj, Grejs.



## ADRIAN GAXHA

### Këngëtari mbështetet tek Elia Shena

Janë të dy pjesëmarës në "Kënga Magjike", por mesa duket janë edhe miq të mirë. Menjëherë pas përfundimit të natës së parë të festivalit, këngëtarët kanë dëfryer në pub me njëri-tjetrin. Dhe ja tek shohim edhe Adrian Gaxhën së bashku me simpatiken, Elia Shena. Ai e ka vendosur kokën në një pozicion jo fort të favorshëm, por gjithsesi komodi të paktën për të. Megjithatë Elia, nuk duket aspak e bezdisur nga Adriani.



## DJALI I JULKES

### Ian ecën vetë

Ka preferuar të ecë vetë, vetëm pak me ndihmën e mamit të tij Julkës, duke e kapur nga bluza e saj dhe lan duket shumë i lumtur. Vogëlushi ka mbushur 1 vjeç tashmë dhe karroca nuk i nevojitet më. Ian është

veshur edhe "trendy", njësoj si nëna e tij Julka. Ai është djali i vetëm i këngëtares simpatike Julka dhe Dj të njohur, dhe menaxherit të përgjithshëm, të studios Muzikore, "Threedot's Production", Andy Gramm.



## LINDA HALIMI

### Lë pa fjalë tre zonja të politikës

Kryetarja e Parlamentit, Jozefina Topalli së bashku me Presidenten e Kosovës, Atifete Jahjaga dhe ish-sekretarja amerikane e Shtetit, Madeleine Albright, janë mrekulluar nga performanca e këng-

ëtares Linda Halimi. Në koncert në Prishtinë, tre femrat e forta të politikës, dukën se janë dorëzuar përpara zërit të Linda Halimit. Këngëtarja përveç performancave, vjen edhe me një paraqitje skenike të kuruar.

**DISLIKE NË YOU TUBE**

# Big Basta: "Më frymëzojnë për tekstet e radhës"

Reperi në kërkim të një shtëpie, për të jetuar me Vesa Lumën

SUADA DACI

**G**erald Xhari, apo siç njihet nga të gjithë me emrin Big Basta, ka nisur aktivitetin muzikor në studion e tij të re muzikore "042 Zone". E mesa duket ka qenë kjo sipërmarrje e re, e cila e ka frymëzuar reperin për të bërë "boom" në Kënga Magjike, ku vjen si këngëtar, tekstshkrues, apo edhe si kompozitor. Por këngët e tij edhe pse cilësore, janë shpesh të sulmuara nga komente dhe dislike në You Tube. Në një intervistë për "Pink Report", këngëtari flet për pjesëmarrjen në këtë event dhe për sulmet e vazhdueshme karshi tij. Ndonëse ka qenë gjithnjë i rezervuar për jetën e tij private, Big Basta ndan me ne edhe planet për bashkëjetesën me këngëtares e mirënjohur dhe njëkohësisht të fejuarën e tij, Vesa Luma.

**Keni pak kohë që keni çelur një sipërmarrje të re, sa të veshtrë e keni patur?**

Disa lekë larg (qesh), por është një sipërmarrje që mua më ka bërë të kënaqur. "042 zone" është ëndrra ime, por në të njëjtën kohë është studio muzikore e të gjithëve.

**Çfarë është "042 Zone" dhe pse është blu?**

"042" është prefiksi i Tiranës, (qesh) është bardh e blu si Tirana. Por bluja është ngjyrë paqeje dhe shumë frymëzuese në të njëjtën kohë.

**Të kanë ndihmuar edhe fansat për të gjetur dizenjon e logos, në fakt sa të rëndësishëm ato janë për ju?**

Janë shumë të rëndësishëm edhe këtë e kam vënë re jo vetëm për studion por edhe kur kam nxjerrë singëlla të rinj, ata më mbështesin shumë. Edhe për këtë studio më dhanë mbështetje të fuqishme, pasi unë e ndjeja tu kërkoja diçka atyre, dhe ata kërkonin diçka të re nga unë.

**Këtë vit keni bërë edhe**



Ka ndonjë inat me mua?! Se di gjithë problemi është se ku e gjejnë veten njerëzit, nëse ata e gjejnë veten mirë duke bërë "dislike: le të vazhdojnë ta bëjnë"

Ka ndonjë inat me mua?! Se di gjithë problemi është se ku e gjejnë veten njerëzit, nëse ata e gjejnë veten mirë duke bërë "dislike: le të vazhdojnë ta bëjnë."

**Ju mërzisnin këto gjëra ?**

Këto më frymëzojnë për tekstet e radhës (qesh).

**Le të ndalemi pak në pjesëmarrjen tuaj në këtë event. Jemi mësuar të shohim Big Bastën si repist po pse sollët dhe Encën si repere?**

Idėja është që kënga kishte nevojë, por dhe tregut i nevojitej një femër që të vinte si repiste. Duke parë edhe nëpër botë se kush po ecën më tepër. Por Enca ka një stil që është

"boom" në Kënga Magjike. Vini si këngëtar, kompozitor, tekstshkrues si ndiheni?

Nuk është se ka bërë Big Basta boom, por u ndjeva mjaft mirë edhe një tjetër vit me KM. U ndjeva ajo pjesë e skuadrës dhe i falenderoj drejtuesit e këtij eventi, që edhe këtë vit pati atë "boomin" e saj.

**Si janë pritur këngët e tua dhe a do të donit të merrnit një gëmim?**

Unë preferoj që pasi të mbaroj

KM, të kem ato reagimet e njerëzve që edhe këtë vit solla një gjë të bukur, pasi ajo është jo vetëm konkurrencë por edhe lojë. Edhe raportet me kolegët këtë vit duket sikur janë sheshuar, në përgjithësi në muzikën shqiptare.

**Në fakt mua nuk më duket sikur po sheshohen nismen edhe nga fakti që shumë nga këngët e tuaja, kanë reagime jo të mira në You tube, ka ndonjë inat apo xhelozji me ju?**

të vërtet për tu lakmuar.

**Dimë që po shkon shumë mirë edhe bashkëjetesa me këngëtares, Vesa Luma po kërkoni për një shtëpi aktuale.**

Jemi në kërkim të një shtëpie. E kemi një shtëpi në dispozicion por duam të zgjerohemi pak, pasi edhe Vesa ka marrë pasaportën shqiptare dhe do të jetojë në Shqipëri tani.

**Si ndihesh Gerald, jeni fejuar në një ceremoni shumë të ngushtë private?**

Po tani fejesa nuk di të bëhet ndryshe, apo të marrim balerina (qesh), por e pranoj jemi fejuar. Nuk më erdh mirë në fakt me gazetaret pasi ishte një lajm që u përfol shumë, kur ajo është një ngjarje personale dhe për atë lajm është mbajtur referat gjithë ditën. Megjithatë ndihem i lumtur.

**Pas KM, ku do t'iu shohim tjetër?**

Po përgatis një mix tape, më pas do të merrem me xhirimet e një klipit, por kam në plan të ngre edhe një lloj stafi apo kompanie, që të ketë mundësi të bëjë video dhe ti transmetojë ato në You Tube.

## KENGETARJA Në studio me Samantën

**N**jë studio muzikore është vendi më i preferuar për këngëtarët. E tillë duket në fakt edhe për këngëtares e ëmbël, Samanta Karavela. Samanta është fotografuar në një studio muzikore, ku po përgatit dy


këngë të reja, një prej të cilave ia ka besuar një kompozitori rumun. E veshur me një pulover ngjyrë pana, këngëtarja në të njëjtën kohë është duke u argëtuar pranë vendit të saj të punës dhe frymëzimit.



## ELVANA GJATA

Pret "boom-in" e radhës

**P**re disa kohësh është duke i munguar skenës shqiptare me një hit të ri, por Elvana Gjata është duke u menduar për këngën e radhës. Ndonëse ka qenë prezente nëpërmjet koncerteve të saj, bukuroshja Elvana Gjata është duke përgatitur dy këngë të reja, me të cilat pritet të bëjë "boom". Sigurisht që edhe këto hite të saj, do të mbajnë firmën e kompozitorit të njohur, Florian Murruges. Jemi në pritje të projekteve më të fundit të Elvanës.





## KËNGA MAGJIKE

# Kush do ta rrëmbejë trofeun?



*Ja këngëtarët gjatë provave dhe pas kuintave të spektaklit*

### SUADA DACI

A shtu si çdo vit, festivali i muzikës së lehtë shqiptare "Kënga Magjike", me producent kantautorin e njohur Ardit Gjebrea pritet të shpall sonte në mbremje fituesin e këtij edicioni. Kanë qenë dy mbremje të mbushura me emocion dhe performanca të shumta nga artistët. Natën e parë janë ngjitur në skenë 23 këngëtarë dhe 21 të tjerë gjatë mbremjes së dytë të eventit. Një pjesë e mirë e këngëve kanë ardhur të shoqëruara edhe me performanca e kërcime. Por këngëtarët kemi mundur ti fotografojmë edhe gjatë provave apo netëve të spektaklit. Gjatë provave të natës së parë shikojmë "Kleoptarën", Ingrid Gjoni sesi performon së bashku me trupën e saj të baletit. Në sallën e Pallatit të Kongreseve shohim edhe mikesha të tjerë dhe saj të ngushtë, Çiljeta Xhilla-ga. Ajo e ka filmuar me telefon performancën e Ingridit dhe nga gjestet, u kuptua që e pëlqeu atë. Me të mbaruar provat e Ingridit, Çiljeta ka ikur dhe vumë re se barku i ishte rritur shumë. Gjatë provave kemi parë edhe shumë artistë teksa rrinë me njëri-tjetrin, Pirro Çako ka qëndruar afër Ermal Mamaqit dhe ka qeshur gjithë kohën me batutat e tij. Alban Skënderaj, i cili pati ovacione nga publiku teksa këndoi natën e parë, e shohim sesi përshendetet me këngëtarën Eni Koçi, e cila është suportori kryesor i motrës së saj, Greta Koçi. Bash-

kë janë fotografuar edhe artistë si Renis dhe Aleksandër Gjoka, së bashku me Vedat Ademin dhe Rezarta Shkurtën. Një tjetër dyshe e suksesshme është fotografuar përpara nisjes së spektaklit dhe ata janë Adrian Gaxha së bashku me Florianin e vogël, po kështu edhe flokëkuqja Enca Haxhia me reperin dhe bashkëpunëtorin e saj, Big Basta. Edhe bukuroshet Olta Gixhari dhe Armina Mevlani, duket se janë ndërjerë shumë mirë në këtë event. Gjatë provave i kemi parë shumë pranë njëra-tjetrës, si dy

mikesha shumë të mira. Surpriza dhe çmime të shumta pritet të kemi edhe në natën finale të KM. Çmimi i madh do të dorëzohet nga fituesi i vitit të kaluar Redon Makashi, por kush do ta fitojë këtë çmim? Janë në fakt një sërë emrash e pretendentë për këtë çmim, nisur kjo edhe nga komentet e ndryshme nëpër rrjetet sociale. Emra si Alban Skënderaj, Aleksandër dhe Renis Gjoka, Vedat Ademi, Rozana Radi, Adrian Gaxha, etj janë për-folur si pretendentët kryesor të çmimit të parë. Megjithatë kjo do të zbulohet





**Vlorë, aksidentohet për vdekje 56-vjeçari largohet shoferi**

Një 56-vjeçar ka humbur jetën rreth orës 13:35 të ditës së djeshme si pasojë e një aksidenti rrugor të ndodhur në zonën e Triportit në Zvërnec të qytetit të Vlorës. Harshi Hamzaj, 56 vjeç, banor në lagjen "Lirim" në Vlorë, ishte duke udhëtuar me motorin e ti, tip Piagio 50 kubik, teksa është përplasur nga një automjet tip Benz me targa AA

38 3EC me drejtues shtetasin me inicialet B.H, 22 vjeç nga fshati Armen i Vlorës. Si pasojë e plagëve të marra 56-vjeçari ka gjetur vdekjen e menjëhershme, ndërsa drejtuesi i automjetit është larguar nga vendi i ngjarjes duke e braktisur mjedin. Sipas informacioneve, mendohet se Hamzaj të ketë qenë në zonën e Triportit për të

peshkuar, ndërsa kur është kthyer është aksidentuar. Policia ka mbërritur në vendngjarje dhe po heton për shkaqet e aksidentit dhe kapjen e drejtuesit të automjetit. Për këtë arsye policia e Vlorës ka ushtruar dje disa kontrolle në kërkim të shoferit të arratisur i cili dyshohet se është edhe përgjegjës për aksidentin e rëndë të ndodhur dje.

Ministri i Drejtësisë prezantoi dje draftin për rishpërndarjen e numrit të gjykatësve

# KLD: Rishpërndarje në gjykata

Shpallet dhe vendi vakant në KLD për zëvendësimin e ish antares Lefterie Lleshi e cila është zgjedhur kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në muajin Tetor

**Lajmi**

Diskutime në Këshillin e Lartë të Drejtësisë për riorganizimin e strukturës dhe numrit të gjykatësve në të gjitha gjykatat e vendit. Halimi paraqet draftin por antarët e KLD-së thonë se drafti duhet rishikuar pasi ka disbalancim të numrit të gjykatësve në gjykata në raport me numrin e dosjeve që ata shqyrtojnë



**Debatet**

Kriteri i shpërndarjes sipas tij, është nisur nga çështjet administrative. Ndërkaq, Ilir Mustafaj u shpreh se sipas tij shpërndarja nuk është e saktë pasi disa gjykata kanë ngarkesë.

vendimet e KLD, të cilat jemi të detyruar t'i respektojmë. Momentet e rëndësishme janë momentet e vlerësimit të karrierës së gjyqtarit. Ne do të vazhdojmë të respektojmë vendimet e marra nga KLD. Vlerësimet e radhës të vlerësohen në vazhdimësi të dinamiksë së gjyqtarëve.", - tha dje Nishani. Më herët në fillim të mbledhjes Presidenti i Republikës kërkoi shpalljen e vendit vakant pas largimit të Lefterie Lleshit, e cila u zgjodh më 11 tetor në Parlament, kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vendim ky i ardhur pas miratimit nga antarët e KLD-së të përfundimit të mandatit të Lleshit, ndërsa Nishani urdhëroi që vendi vakant t'i dërgohet Kuvendit. "Mirënjohje Lefteri Lleshit për punën e saj si anëtare e KLD-së. I uroj që asaj suksese në detyrën e saj të re si kryetare e KQZ-së", - tha Nishani.

**LAJME SHKURT**

**■ Tiranë, digjet automjeti në bulevard**  
Përshihet nga flakët një makinë në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" në kryeqytet. Ngjarja ndodhi rreth orës 19:30 të mbrëmjes së djeshme, ndërsa mësohet se mjete tip "Renault Shenik" ishte i parkuar në afërsi të hotel Dajti. Ende nuk dihen shkaqet e rënies së zjarrit në makinë. Policia e mbërritur në vendngjarje, po heton për shkaqet e zjarrit, ndërkohë që një zjarrfikës është angazhuar për të shuar flakët. Ende nuk është përcaktuar nëse djegia e automjetit ka qenë një mesazh për pronarin e saj apo nëse ka qenë një ngjarje e ardhur si pasojë e problemeve teknike të makinës. Ky është rasti i tretë brenda kësaj jave kur një makinë gjendet e djegur në kryeqytet, dy ditë më parë një tjetër automjet është gjetur tërësisht i shkrumbuar në zonën e Kombinatit, ndërsa për këtë rast policia po heton pësten e një zjarrvënies të qëllimshme.

**■ Kanabis dhe granata shqiptarë në Athinë**  
Policia greke ka arrestuar një shqiptar 29 vjeç, pasi në shtëpinë e tij në Athinë, u gjetën 418 kilogramë kanabis, dhe një sasi armësh si pistoleta, fishekë, granata dhe detonatorë. I arrestuari ishte larguar nga burgu i Larisës në vitin 2010, ku vuante dënimin për trafik drogë dhe që atëherë ishte shpallur në kërkim. Policia kishte informacion për importantimin e drogës dhe armëve nga Shqipëria dhe pas hetimeve, ushtroi kontroll në banesën e 29 vjeçarit, e cila rezultoi të ishte një magazinë e vërtetë drogë dhe armësh. Pas kontrollit u gjetën dhe u konfiskuan 418 kg kanabis, 2 pistoleta, një silenciator, 3 granata, një detonatorë bombë, 9 detonatorë me tela, rreth 950 fishekë, 3 peshore elektronike precize, 870 Euro, 3 telefona celularë dhe një dokument fals qëndrimi si minoritar.

Në foto: Mbledhje e Këshillit të Lartë të Drejtësisë

**TIRANE**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë diskutoi dje draftin për rishpërndarjen e gjyqtarëve në gjykatat e rretheve dhe të Apelit.

Ministri i Drejtësisë paraqiti draftin e përgatitur pas një studimi të realizuar nga ministria e Drejtësisë në gjykatat e vendit. Drafti i cili pritet të votohet në KLD synon rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor, duke i garantuar publikut një shërbim më cilësor e më të shpejtë. Ministri i Drejtësisë, Eduard Halimi tha se rishpërndarja nuk do të bëhet në sajë të çështjeve që ka një gjyqtar. Kriteri i shpërndarjes sipas tij, është nisur nga çështjet administrative. Ndërkaq, Ilir Mustafaj u shpreh se sipas tij shpërndarja nuk është e saktë pasi disa gjykata kanë ngarkesë. Duke

vlerësuar të gjitha ndërhyrjet që u bënë në këtë tryezë, presidenti Nishani tha se është shumë e rëndësishme shpërndarja e ngarkesës së gjyqtarëve pasi do të lehtësohej puna e gjyqtarëve, ndërsa si një tjetër pikë të rëndësishme renditi edhe krijimin e lehtësisë në aksesin e qytetarëve në drejtësi.

**PROJEKTI**

Nga ana e tij dhënë detaje për këtë projekt, ministri i Drejtësisë, Eduard Halimi, tha se "kemi përgatitur një draft të rialokimit të të gjithë numrit të gjyqtarëve sipas

çdo gjykate". Sipas tij, drafti parashikon rishpërndarjen e gjyqtarëve në gjykata, sipas ngarkesës së tyre në punë. Përmes këtij akti synohet që të ulët numri i gjyqtarëve në gjykatat e vogla të rretheve që kanë më pak çështje dhe të rritet numri i gjyqtarëve në gjykatat që kanë një ngarkesë më të madhe pune. Kjo nisimë pritet t'i japë zgjidhje problematikës së hasur në vepërimtarinë e sistemit gjyqësor. Si shembull përmendet rasti i Gjykatës së Tiranës, me 70 gjyqtarë, ku një gjyqtar ka në ngarkim rreth

300 dosje, në një kohë që në Gjykatën e Gjirokastrës, me 16 gjyqtarë, një gjyqtar ka në ngarkim rreth 30 dosje. Një situatë e tillë ka krijuar probleme në dhënien e drejtësisë në kohë të shpejtë për qytetarët.

**NISHANI**

Kreu i KLD-së, Presidenti bujar Nishani nënvizoi nevojën e vlerësimit të gjyqtarëve mbi bazën e karrierës dhe kurrikulave."Ky këshill ka një sfidë sepse fatkeqësisht nuk kemi një praktikë të nisur herët të sistemit të vlerësimeve, bazuar mbi

**Përplasja**

## Durda-Gjyqtarëve: Kujdes, do ta paguani

**TIRANE**

Tragjedia e Gërdecit ka përplasur sërish në sallën e gjyqit familjarët e viktimave me togat e zeza. Zamira Durda që humbi djalin e saj në këtë tragjedi u ka kërkuar gjyqtarëve të Apelit të bëjnë kujdes me vendimet që do të japin. "Kujdes vendimet që do të jepni ose do ta paguani për këtë që po bëni" - u është drejtuar Zamira Durda trupit gjykues në Gjykatën e Apelit. Si prokuroria ashtu dhe 28 të pandehurit kanë apeluar vendimet e Gjykatës së Tiranës në Gjykatën e Apelit. Prokuroria kërkoi dënimin më të ashpër se ai që është dhënë nga gjykata e një shkalle më të ulët, ndër-



Zamira Durda

sa të pandehurit kërkojnë uljen e dënimit. Seanca e djeshme ishte e dyta në Gjykatën e Apelit. Avokatët i kërkuuan Gjykatës të hedhë poshtë ankimmimin e prokurorisë, ndërkohë që prokuroria kërkoi dokumentacion shtesë për ankimmimin e të pandehurve pasi të pandehurit kanë bërë një ankimmim të përgjithshëm dhe jo individual. Gjykata rrefuzoi kërkesën e avokatëve dhe kërkoi shtyrjen e seancës. Në këtë moment ka ndërhyrë tepër e irrituar Zamira Durda, e cila ndodhë në sallë për të ndjekur seancën. "Kam 4 vjet që i dëgjoj këta plehra, (e ka fjalën për avokatët) Kërkoj të vihet në vend drejtësia." Paralamërimëve nga gjyqtari se do

nixirrin jashtë nga seanca ajo i është shprehur se nuk donte t'ia dinte. "Kujdes vendimet që do të jepni ose do ta paguani për këtë që po bëni" - u është drejtuar Zamira Durda trupit gjykues në Gjykatën e Apelit. Dosja Gërdeci u rikthye në Gjykatën e Apelit pas kërkesës së 28 të pandehurve për ndryshimin e masës së dënimit dhënë nga Gjykata e Tiranës. Për Ylli Pinarin dhe Dritan Minxollin togat e zeza dhanë dënimin me 18 vjet heqje lirie, ndërsa për administratoren e shoqërisë "AlbaDemil", Mihal Delijorgji u caktua masa e dënimit me 10 vjet burg. Katër të pandehurit kyç të kësaj dosje po gjykohen nën masën e sigurisë arrest shtëpie.



Refleksion

# Historia, është mësuese e jetës



NGA SHPËTIM GJIKA  
vijen nga faqja 1

...asaj ngrehine që sot e shohim të përfunduar, të realizuar e përpqemti t'ia ndreqim defektet, por që atëherë, ato ditë të trazura të 100 viteve më parë, ishin thjesht ëndërr e ideal i atij grushti njerëzish që e bënë nga e para Shqipërinë. Në një klimë të përgjithshme të skepticismit për këdo e për gjithçka, do të kërkoj lejen tuaj që të shpreh edhe unë disa konsiderata personale, sigurisht pa pretenduar të bëhem as historian, as revizionues i historisë, gjë që s'kam pretenduar ta bëj në mjedis të tjera e jo më sot në mes të "ustallarëve" të historishkrimit.

Më ka bërë një përshtypje të veçantë fakti që profesor Puto i kthehej kësaj vepre të tij pas gati 35 vitesh për ta ripunuar, për ta rivlesëuar e për ta përmirësuar, nën dritën e kërkimeve e burimeve të reja arkivore, por edhe në refleksim të prurjeve e koncepteve të reja metodologjike në shkencën e historiografisë.

Vepra e tij "Pavarësia shqiptare dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914", e risjellë në këtë 100 vjetor, është një dëshmi e sigurtë se historia nuk është një formulim i pandryshueshëm, por përkundrazi, është një proces zhvillimi, një pasurim i vazhdueshëm i koncepteve dhe i qëndrimeve mbi ngjarjet. Janë plot 6 arkiva të shfrytëzuara nga profesori për këtë libër, nga Tirana në Vjenë, në Paris, Romë, Londër.

Burime dokumentare e arkivore pa fund, të trajtuara e të analizuar nga një studiues që mendoj se ka pasur një përparësi të madhe në raport me fushën e studimit: ai është njohës e specialist i së drejtës ndërkombëtare.

Dhe tani ne e kemi shumë të qartë se shpallja e pavarësisë së Shqipërisë ishte një akt i mirëfilltë juridik që u formulua e u shpall nga një diplomat "par exelance", siç ishte Ismail Qemal Vlora, dhe u paraqit e u mbrojti në një terren të mirëfilltë diplomatik, mu në qendër të ndërthurjes së interesave të fuqive e shteteve shumë më të konsoliduara e më të fuqishme se Shqipëria e saposhpallur si shtet.

I ndëruar profesor, më erdhi ndër mend këto ditë që pata në duar librin tuaj, një sentencë latine që ne e mësonim dikur në shkollë: "Historia magister vitae est" (Historia magister vite est). E ka thënë Ciceroni dhe në shqip përkthehet "Historia është mësuese e jetës".

E meqë kjo Histori e Pavarësisë së Shqipërisë për më tepër është shkruar nga një Profesor si ju, du të ndaj disa nga mësimet që unë vetë kam nxjerrë nga ky libër.

Mësimi i parë është se "Ideali dhe misioni i lartë ngrihen mbi çdo realitet, sado kundërshtues e problematik, sado negativ e kundërvënës të jetë ai". Etërit e pavarësisë së Shqipërisë dhe kryetari Ismail Qemali,

vepruan e punuan në një terren e në një atmosferë tejet armiqësore e penguese, por gjithmonë të udhëhequr nga një ide e qartë e nga parime të qëndrueshme, siç ishte e drejta historike e shqiptarëve për të konfirmuar ekzistencën e tyre në një shtet të pavarur.

Për ta realizuar misionin e tyre, ata shkëlën edhe mbi veten, mbi dalimet e mbi dasitë e tyre, por duke u orientuar nga qëllimi fisnik, ia dolën të bëhen bashkë e të merren vesh.

Mësimi i dytë është se "Fjala e marrëveshja, shoqëruar me këmbënguljen, janë formula fituese për suksesin e çdo sipërmarrjeje".

Është tepër domethënës dhe madje është edhe burim krenarie për të gjithë ne fakti që ai të cilin ne e kemi nderuar dhe e nderojmë edhe sot si babain e Pavarësisë shqiptare, Ismail Qemali, nuk ishte ndonjë gjeneral ushtarak apo ndonjë hero lufttrash, por ishte një diplomat e politikan profesionist që jo vetëm me një intuitë të shkëlqyer politike, por edhe falë shkollimit e profesionalizmit të tij, i armatosur vetëm me artin e bindjes e me forcën e fjalës, iu fitoi "detit më këmbë" (siç themi ne këtë nga Vlora) e mundi të bëjë realitet atë që as nuk ishte guxuar të artikulohej më parë apo të mendohesh si një aspiratë e realizueshme.

Sigurisht që nuk e bëri i vetëm, sigurisht që luajti me zgjuarsi në skakierën e interesave e politikave ndërkombëtare, mes aleatësh të vendosur për ta mbështetur e armiqsh edhe më të vendosur për ta



Shpëtim Gjika, kryetar i Bashkisë së Vlorës, gjatë ceremonisë së promovimit të librit të profesor Arben Putos

penguar. Por këto jo vetëm nuk ia zbehin vlerën veprës së tij historike, por përkundrazi e ridimensionojnë dhe e lartësojnë edhe më tej figurën e tij. Jo më kot ai ka hyrë në kujtesën e mirënjohjen popullore duke u mbiquajtur "plaku i urtë i Vlorës".

Mësimi i tretë mendoj se është edhe më i rëndësishëm e më aktual. Ai ka të bëjë me mënyrën se si e konceptojmë dhe si e konsumojmë ne historinë. Historia nuk është një godinë e artë, mondanë, në të cilën hyjnë vetëm disa njerëz të privilegjuar, gatë-gatë të predestinuar për të.

Jo historia është ajo që ne, ju, secili prej nesh e shkruan çdo ditë me punën dhe veprën e tij, me punën e veprën tonë në të mirë të njerëzve tanë e të vendit tonë.

Kjo duhet të na bëjë ne më të përgjegjshëm e më të vetëdijshëm se puna jonë e sotme nuk është e nuk mund të jetë vetëm për sot, por sidomos për nesër e në dobi të atyre që nesër do t'i shijojnë frutet e punës sonë.

Ismail Qemali e bashkëpunëtorët e tij nuk e dinin e nuk mund ta dinin atëherë se çfarë qëndrimi do të mbante historia e shkruar për ta e për veprën e tyre.

As nuk mund ta mendonin se do të ngjiteshin në piedestale të larta të historisë së pasur të Shqipërisë.

Dhe as që u nisën me këtë mendim. Ishte vepra e tyre që i bëri të pavdekshëm. Një vepër të cilën ata vetë as nuk e panë të realizuar dhe as e gëzuan dot.

Por jemi ne që e trashëgojmë sot

një Shqipëri 100 vjeçare e që shpresojmë e punojmë që më të zhvilluar e më të përparuar tua lëmë trashëgim brezave pasardhës.

I lindur në vitin e 50 të shpalljes së Pavarësisë, unë nuk pata fatin ta jetoj me vetëdije atë stacion të gjysmëshekullit të parë të vendit tim.

Sivjet që ai mbush një shekull jetë, jam unë që tashmë kam mbushur një gjysmë shekulli. Kjo lojë shifrash më çon te mendimi se atdheu ynë është mjaft i ri në moshë. Gjysmën e viteve të tij e kam unë vetë dhe më besoni, ndiejem ende shumë i ri.

Jo vetëm kaq, por intensiteti i ngjarjeve të përmasave të mëdha që kemi përjetuar më bën të mëndo se historia jonë moderne është mjaft e pasur, se ne jetojmë njëherazi në një dimension aktual e në një tjetër dimension historik.

Vetëm në këto 20 e ca vite të fundit ne kemi jetuar së gjalli përmbyshje e një rregjimi politik nga më stoikët në botë, kemi parë gati shkëmbim të rregjimit të atdheut tonë, prapë e një lufte të tmerrshme civile dhe ringritjen spektakolare të tij në shumë pak kohë.

Ne gjithashtu kemi qenë dëshmitarë të gjallë të mrekullisë së lindjes së një tjetër shteti të pavarur shqiptar, të Kosovës që po afirmohet ndërkombëtarisht çdo ditë e më shumë e me të cilin mesa duket kemi lënë një takim bashkimi në stacionin e përbashkët të Evropës së bashkuar. Le të punojmë të gjithë së bashku që ta realizojmë sa më shpejt këtë ëndërr të të gjithë shqiptarëve.

Analiza

# Ushtria e NATO-s dhe ushtria e natës



NGA GENCI KOJDHEHI  
vijen nga faqja 1

...me pak fjalë kanë qënë pjesë logjike e një debati deri diku normal për çdo vend që rreket të zhvillohet demokratikisht e të ecë përpara. I vetmi përjashtim, për vite me rradhë, ka qënë ai i sektorit të sigurisë, e veçanërisht i forcave të armatosura. Për shkak të një konsensusi të gjithëpranuar mes forcave politike, dhe një interesi të dukshëm gjeo-politik për të qënë pjesë e NATO-s, për vite me rradhë sektori i mbrojtjes duket se i kish të gjitha "letrat në rregull", gjeneronte vazhdimisht që farë konsensusi të heshtur, dhe qëndronte jashtë sferës së njollosjes që karakterizon përgjithësisht punët e shtetit në këtë vend. Rrjedhojë e kësaj mise-en-scène politike ka qënë edhe suksesi i vazhdueshëm i Ministrave të Mbrojtjes, të cilët për vite me rradhë punonin "rehat" dhe korrnin frytet e suksesit nën petkun e

magjishëm të "integritimit në NATO."

Gjithë sa më lart ndryshoi me 15 Marsin e 2008-ës; ngjarja tragjike e Gërdecit nxorri në pah një realitet të hidhur të mungesës së kontrollit mbi strukturat e sigurisë, të cilat, të lëna me pak ose aspak supervizion civil, ishin përfshirë në një aferë abuzive e korruptive e cila rezultoi edhe në viktima. Dhe ndonëse integrimi në NATO u arrit pikërisht atë vit, ne si shoqëri besoj se kemi kuptuar se asnjë sektor i qeverisjes (aq më pak sektori i sigurisë, i cili teknikisht zotëron i vetëm edhe monopolin e forcës në shoqëri) nuk duhet të jetë off-limits nga vëmendja e mediave, opozitës, dhe publikut të gjerë. Fatkeqësisht, atë që kupton shoqëria jo gjithmonë arrin ta kuptojë edhe qeveria, dhe historia duket se po përsëritet këtë rradhë me një skandal ndoshta edhe më të madh që përshin përsëri Ministrinë e Mbrojtjes. Opozita, duke iu referuar qartazi dispozitave Kushtetuese mbi komisionet parlamentare, ka kërkuar ngritjen e komisionit hetimor për veprimtarinë e Ministrisë së Mbrojtjes, ngritja e së cilit u refuzua prej mazhorancës duke pretenduar se objekti i hetimit duhet të rishikohet, një pretendim qesharak kur mendon se sa i

gjerë duhet të jetë spe.

Reagimi i mazhorancës, e veçanërisht sjellja e Gjykatës dhe përfaqësuesëve parlamentarë të saj, është tejet shqetësuese dhe tregues real i mungesës së përfaqësimit të denjë që shqiptarët kanë në Kuvend. Roli i parlamentit dhe i kontrollit supervizion që parlamentarët duhet të ushtrojnë mbi sektorin e sigurisë është një prej gurëve të themelit në marrëdhëniet mes publikut dhe forcave ushtarake, kjo sepse asgjë ushtri nuk mund të funksionojë e të jetë e suksesshme pa pasur mbështetjen e popullit të cilin ajo pretendon se mburon, dhe interesi i popullit në këtë rast përfaqësohet drejtpërsëdrejti prej parlamentit. Ngjarje si ajo e Gërdecit duhet të jenë mjaftueshëm justifikim për të pranuar pa asnjë klauzolë faktin se, teksa parlamenti nuk duhet t'i tregojë ushtrisë se si të bëjë detyrën, ai duhet absolutisht të ketë aftësinë që të mbahet rregullisht i informuar mbi të gjitha veprimtaritë e forcave të armatosura, dhe të supervizionojë çështje të ndjeshmërisë së lartë, si prokurimet e armatimit, buxhetimi dhe administrimi i fondeve, apo edhe përgjimet, si në rastin në fjalë. Strukturat ushtarake dhe

ekzekutive sigurisht që do duhet të vazhdojnë funksionet e tyre të paracaktuara nga Kushtetuta dhe prioritetet që vendi ka si anëtar i NATO-s, por të dy duhet të jenë të vetëdijshme për faktin se Kuvendi i ka vëmendjen dhe sytë e përqëndruar mbi punën e tyre.

Pehlivanllëqet e ekzekutiv dhe mazhoranës për të evituar apo vonuar kontrollin parlamentar mbi Ministrinë e Mbrojtjes nuk bëjnë asgjë më tepër se sa rrisin dyshimet mbi 'pislëqet' që mund të zbulohen prej komisionit hetimor. Gjithashtu, justifikimet se kontrolli i parlamentit është problematik pasi publiku nuk mund të informohet mbi çështje specifike të karakterit sekret janë tërësisht pa sens, pasi vetë Aleanca e Atlantikut Verior ka theksuar se kontrolli civil mbi forcat e armatosura është një kërkesë e panegociueshme e çdo demokracie, dhe ky parim zbatohet rëndom në vendet e NATO-s. Ushtria jonë nuk mund të jetë edhe e NATO-s edhe e natës, të trumpet-ojë arrijtë ditën e të fshehtë paudhësi nëpër errësirën e krijuar prej 'sekretit ushtarak' dhe 'konfidencialitetit'; kjo së pari për të përmbushur standartet demokratike të Aleancës, e së dyti dhe më e rëndësishmja, për të evituar ndonjë tjetër "aksident teknologjik" që merr jetë shqiptarësh.



# Intervista

■ ■ ■ TIRANE

DHURATA HAMZAI

**AKTORI** që u bë i famshëm në Shqipëri me personazhin e kryemafiozitet të filmi "Oktapodi" vizitoi dje Shqipërinë. Intervista dhe batutat humoristike me gazetarët...

# REMO GIRONE

## Ndryshoj nga Placido, është martuar 25 herë

### "Tano Karidi" rrëfen censurat e "Oktapodit"

Remo Girone, aktori i mirënjohur italian ka udhëtuar gjithë natën dhe ka mbërritur dje në mesditë në Tiranë për të qenë prezent në mbrëmjen "Gala" të festivalit të 13-të të filmit shqiptar si i ftuar nderi. Girone, aktori që u bë i famshëm në Shqipëri me personazhin e kryemafiozitet Tano Karidi në filmim "Oktapodi" u është përgjigjur pyetjeve të gazetarëve dje në konferencën për shtyp në orën 13.00 me një karizëm interesante, batuta të bukura dhe të qeshura të forta. Nuk kanë munguar batutat për kolegun e tij Michele Placido, Katanin, për marrëdhëniet me gratë "që është martuar 25 herë" dhe për marrëdhënien e tij besnike me bashkëshorten Viktorian, me të cilën nuk është ndarë prej 30 vjetësh që nga dita e martesës. Girone nuk ngurron të rrëfejë sesi e ka luajtur Tano Karidin, rolin për të cilin shqiptarët e vlerësojnë dhe e adhurojnë, ku tregon se filmi i ka paraprirë kritikës mbi mafian italiane, para se faktet të bëheshin të njohura nga media. Ndërsa dje në mbrëmje Remo Girone ishte në ceremoninë e ndarjes së çmimeve të Festivalit të 13-të të filmit shqiptar në Teatrin e Operës dhe Balletit, ku ishin të pranishëm një varg personazhesh të njohura nga fusha e artit dhe politikës.



Aktori italian, Remo Girone dje në Tiranë. Rrëfimi me gazetarët

#### Keni qenë ndonjëherë tjetër në Shqipëri?

—Është hera e parë që vij në Shqipëri dhe nuk kam pasur njohuri për shumë gjëra nga Shqipëria dhe nga kinematografia shqiptare. Njoh një pjesë të atyre që kanë origjinë shqiptare dhe një vend që quhet Piana de Albanezi dhe aty ndodhen ata.

#### Shqiptarët ju kanë dashur, duke ju urreyer në film. Si mundët ju ta realizonit aq bukur rolin dhe sa i keni njohur nga afër krerët e mafies italiane në atë kohë?

—Dua të them se ky ishte një problem më i madh për skenaristët sesa për mua si aktor në atë kohë. Unë kam qenë një personazh shumë i njohur, sidomos mbas serisë së katërt të "Oktapodit". Atëherë ishte hera parë që në një film në Itali shihet historia e mafies në nivelin ku komandoheshin gjërat nga krerët financiarë që janë lidhur me botën e mafies. Mendoj se personazhi ishte shumë interesant sepse kishte karakteristikat humane dhe nuk ishte jonjerëzor. Dhe në një pikë mund të them se ishte edhe i mirë. Për mua për t'ju përgjigjur pyetjeve tuaja është një gjë interesante, sepse ato që tregonin në film ishin shumë të lidhura me realitetin. Të gjitha seritë që vinin para serisë së filmit Mani Pulite, nuk e di nëse e njihni apo jo. Pra mund të

them pas filmit Mani Pulite gjërat vinin edhe më të qarta. Seritë e filmit vinin para publikimit të fakteve në gazeta. Pra, më përpara ekzistonin seritë, por gjërat nuk mund të thuheshin shumë qartë sepse faktet nuk mund të dilnin nëpër gazeta. Pas këtij episodi, faktet filluan të nxirreshin edhe nëpër gazeta dhe ishte e mundur për ne të tregonin këto fakte në seriale. Pra, mund të them se disa seri të "Oktapodit" kalonin në censurë. Mbaj mend që shumë ndryshime bëheshin edhe në dublime. Pra një personazh që ishte deputet, bëhej një ish-deputet. Mund t'ju tregoj një episod. Njëherë u xhirua një skenë në Pallatin e Andreotit, ku ai kishte zyrën. Pra, xhirohej skena e një mafiozi që takonte një politikan. Dhe e gjitha skena u hartua në plan të parë, në mënyrë të tillë që të mos dallohej

se ku po xhirohej (Qesh).  
**Pse ju ndoqi gjithmonë roli i personazhit negativ?**  
—Është e vërtetë që shpeshherë më kanë caktuar personazhe negative, por jo vetëm të tilla. Të them të drejtën, të luajturit e personazhit negativ nuk ka qenë ndonjëherë problemi im, ai ka qenë problemi i regjisorit apo producentëve që më kanë zgjedhur për këto role. Për shembull, tani unë kam bërë dy filma për kinemanë, njëri është për emigrimin dhe tek ky film unë recitoj bashkë me gruan time pjesën e një emigranti italian që do të kthehet në vendin e tij. Pastaj kam bërë një film tjetër ku isha një gjysh i lezecëm dhe tani do bëjë një film tjetër që quhet komik, "Mirëdita president".

**Për çfarë flet ky film?**  
—Filmi "Mirëdita President" është

një komedi mbi politikën italiane. Duhet të sjellin një president të ri për shtetin dhe rolin e këtij e bën Andrea Molaioli. Ka shumë ndryshime në karakterin që kam unë. Ka ca skena humoristike, sepse në parlament janë duke u bërë zgjedhjet dhe njëri propozon Xhuzeppe Garibaldin për president. Dhe i thotë njëri: "Ky ka vdekur!". "Pikërisht.", i thotë ai tjetri. "Epo atëherë le të gjemë një emër që quhet Xhuzeppe Garibaldi. Dhe fakti ishte për të qeshur se aty kishte vërtetë një njeri që kishte emrin Xhuzeppe Garibaldi. Pra, roli im në këtë film është drejtori i shtypit në Pallatin e Presidentit. Pra, filmi nuk është kundër politikës në përgjithësi, por mënyrës së të bërit politikë në Itali.

#### A e keni pasur të vështirë të kaloni nga një rol mafiozi në role humoristike?


—Këto rolet "serioze" më kanë bërë pak dëm në fakt, sepse jo vetëm tek "Oktapodi", por edhe në një farë periudhe kam bërë shumë role dramatike. Por unë kam bërë edhe komedi. Për shembull, komedia "Lule Kaktusi" ka qenë një sukses i madh. Pra me këtë komedi, unë kuptova se është bukur t'i bësh njerëzit për të qeshur. Por..., edhe që është po aq e vështirë ta bësh sa rolet serioze. Mua më pëlqejnë gjërat e vështira.


#### Michele Placido me rolin e Katanit, së paku këtu në Shqipëri, i ka bërë për vete gratë. Po ju vetë ç'marrëdhënie kemi me gratë?


—Unë ndryshe nga Michele nuk jam martuar 25 herë. Unë jam martuar prej 30 vjetësh me Viktorian dhe ka ndodhur vetëm njëherë. Dhe kjo më krijon shpesh situata humorit me gazetarët. Kur na bëjnë ndonjë fotografi bashkë më thonë: "Po në këtë fotografi e kemi...". (qesh). Më vjen keq do të doja të jepja material për revistat gossip, por unë nuk kam si Michele disa gra dhe disa fëmijë me gra të ndryshme. Pra, tek unë nuk ka periudha në jetën time që të jetë një mundësi e tillë. Por, mund t'ju them se e kam pasur këtë mundësi edhe tani. Unë kam bërë një rol tek "Oktapodi" ku burri kishte shumë


fuqi, shumë pushtet dhe e di që grave iu pëlqen kjo gjë, pushteti dhe fuqia. Prandaj mund të them se isha i suksesshëm. Ndoshta kohët e fundit kam zgjedhur të bëj komedi se di që gratë duan t'i bësh për të qeshur... (qesh me të madhe)


## HOROSKOPI


**Dashi**  Sot për shënjën tuaj diskutimet në çështjet ekonomike do jenë shumë të favorizuara. Gjithashtu, do ndjeheni se në lidhje me punën tuaj do keni epërsi dhe mundësi t'i shikoni gjërat më të stabilizuara apo me perspektivë.


**Demi**  Dita e sotme ka shumë mundësi të jetë për ju një ditë ku bashkëpunimi do sjell ecuri të mira në punën tuaj. Në aspektin sentimental sot do keni mundësinë e ekuilibritit të marrëdhënies tuaj si dhe vendimmarrje të mira ekonomike.


**Bizjakët**  Dita e sotme ka shumë mundësi të jetë një ditë ku në çështjet familjare apo bizneset familjare do arrini një marrëveshje të mira apo do keni mundësinë e bisedave konstruktive. Njohje të mira vijnë nga njerëz të afërt.


**Gaforja**  Dita e sotme do ketë në vëmendjen tuaj, jo vetëm çështjet sentimentale, të cilat do jenë në një ditë fatume por edhe çështje të një veprimtarie të rëndësishme tuajën e cila do përparojë. Përpikuni të shikoni pas pasionit tuaj.


**Luani**  Dita e sotme ka si mundësi të mirë lajme të kënaqshme për sa i përket punës apo veprimtarive të cilat ju frymëzojnë apo ju bëjnë më shumë krijues. Do keni lajme të mira familjare apo çështje ligjore që përparojnë.


**Virgjëresha**  Sot do arrini më në fund të bini në sy aty ku duhet dhe të bëni përshtypje aty ku do ju jepen mundësi për të përparuar në lidhje me planet tuaja. Ka ardhur momenti që edhe të shpalosni hapur ndjenjat apo idet tuaja.


**Peshorja**  Dita e sotme sjell një mundësi të mirë në çështjet ekonomike sidomos nga një veprimtari e fshehtë. Gjithsesi munda dhe të përjetësuat tuaja do shpërblehen megjithatë ju nuk mund akoma të ndjeheni të lirshëm.

**Akrepi**  Dita e sotme do jetë për ju një shans i mirë bisedash apo takimesh sidomos me miq e shokë ku jeta tuaj sociale do marrë një ritëm të dukshëm. Keni njohje të mira në rrethin shoqëror edhe në aspektin erotik.

**Shigjetari**  Dita e sotme do ketë në vëmendjen tuaj çështje të punës apo të karrierës. Do jeni disi mistik në lëvizjet tuaja sidomos në çështje pune apo në strategji që kanë të bëjnë me çështje të ndryshme ligjore.

**Bricjapi**  Dita e sotme do ju përcjell një energji shumë pozitive në lidhje sidomos me planet dhe lajmet që prisi. Ka shumë mundësi të përparoni në situatë udhëtimi studimi ligjore apo çështje të ndryshme kualifikimi.

**Ujori**  Dita e sotme do jetë në vëmendjen tuaj si një ditë ku nuk do arrini të kuptoni se kush do ketë më shumë rëndësi ekonomia apo mënyra se si ndjeheni për personat që ndjehet për ju. Nuk dini se kujt i përkushoheni më shumë.

**Peshqit**  Kjo ditë mund të quhet ditë bashkëpunimesh kontratash marrëveshesh apo udhëtimeve e kontaktesh me njerëz që jetojnë larg jush në këtë periudhë. Përpikuni të jeni aty në këto situatë bisedash apo shansesh bashkëpunimi.

**ASTROLOGE**

**MERI SHEHU**

0900 673 4000

LAJME  
NGA BOTA

■ **Obama diskuton bashkëpunimin me 13 liderë botërorë**

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Barack Obama ka folur me telefon me 13 liderë botërorë, që nga rizgjedhja e tij më 6 nëntor. Shtëpia e Bardhë ka thënë se Obama ka shtafur shpresën për bashkëpunim më të ngushtë me ta gjatë mandatit të dytë katërvjeçar në postin e presidentit. Sipas njoftimit, Obama ka folur me udhëheqësit e Izraelit dhe të Egjiptit – dy vende këto të Lindjes së Mesme që marrin miliarda dollarë ndihma nga Shtetet e Bashkuara.

■ **Clinton nderon ambasadorin Stevens**

Sekretarja amerikane e Shtetit, Hillary Clinton, ka nderuar Chris Stevensin, ambasadorin e Shteteve të Bashkuara në Libi, i cili është vrarë nga një sulm më 11 shtator. Duke folur në një ceremoni në Uashington, Clinton ka thënë se Stevens është një "hero i rënë", i cili e ka kuptuar se diplomacia amerikane kërkon të ndërmerren rreziqe në zona të rrezikshme, transmeton REL.

■ **Britania alarmohet nga numri i madh i imigrantëve**

Sipas një raporti të publikuar në Londër, deputetët britanikë kanë shprehur shqetësimin e tyre për rritjen dhe daljen jashtë kontrollit të rasteve të imigracionit (hyrjes së emigrantëve të huaj). Shifra e dosjeve që presin të shqyrtohen apo atyre që depozitohen në arkiva, ka kaluar 300 mijë dhe është thuhet sa popullsia e Islandës. Vetëm në tre muajt e fundit janë shtuar 26 mijë raste, sipas Komitetit Parlamentar për Rendin. Në rastet e pazgjidhura përfshihen rreth 4 mijë kriminelë të huaj të liruar nga burgjet, por që nuk janë deportuar dhe jetojnë aktualisht në Britani.

■ **Brenda një nate, 9 000 sirianë ikën për në Turqi**

Agjencia për Refugjatë e Kombeve të Bashkuara ka bërë të ditur se mbi 9 000 sirianë kanë hyrë në Turqi brenda natës së shkuar. Mediat turke raportojnë se 26 zyrtarë të ushtrisë siriane janë në mesin e refugjatëve të rinj në Turqi. Sipas Agjencisë për Refugjatë, që nga e enjta rreth 1 000 sirianë të tjerë kanë kaluar në Liban dhe 1 000 të tjerë në Jordani. Fluksi çon në më shumë se 400 000 numrin refugjatëve të regjistruar sirianë në rajon.

■ **Tibetanët protestojnë kundër Kinës**

Qindra tibetanë kanë marshuar sot kundër sundimit të Kinës në rajonin e Tibetit. Protesta është zhvilluar në qytetin Longyu të provincës Qinghai, transmeton REL. Ajo pason gjashtë incidente të vetëdijes vetëm brenda kësaj jave, në shenjë kundërshtimi ndaj sundimit kinez në rajonin e Himalajeve. Autoritetet kineze kanë akuzuar Dalai Lamën, liderin shpirtëror të Tibetit, i cili ndodhet në mërgim, se nxit tibetanët që t'i vënë vetes zjarrin dhe të organizojnë protesta.

■ **Protesta kundër korrupsionit në Buenos Aires**

Mijëra persona kanë dalë nëpër rrugët e kryeqytetit argjentinas, Buenos Aires, për të protestuar kundër Qeverisë së presidentes Cristina Fernandez. Aktivistët opozitarë kanë përdorur rrjetet sociale për të mobilizuar marshimin, që sipas tyre ishte një nga protestat më të mëdha anti-qeveritare në dekadën e fundit. Pjesëmarrësit thanë se ishin të irrituar prej inflacionit në rritje, nivelit të lartë të krimit dhe rasteve të shumta të korrupsionit të drejtuesve të lartë.

# [SHQIPTARJA.com]

## NE VERSIONIN DIXHITAL



DUKE BLERË ABONIMIN, JU MUND TË LEXONI GAZETËN QË NGA ORA 2:00 E MËNGJESIT, DHE PAGUANI MË PAK

Lexojeni gazetën në

iphone

Gazetën e gjeni:  
[www.shqiptarja.com](http://www.shqiptarja.com)



në kompjuter



ipad

SHKARKON FALAS  
APP TE SHQIPTARJA.COM  
NGA APPLE STORE



• Alba Malltezi  
Drejtores e Përgjithshme  
e Free and Fair Media Group

• Anila Basha  
Drejtores e Shqiptarja.com  
• Arben Rozhani  
Kryeredaktor

**Politika:** Jakin Marena  
**Ekonomia:** Genc Kondi  
**Kronika:** Habjon Hasani

**Sociale:** Esmeralda Keta  
**Kulturë:** Admirina Peçi

**Design:** Altin Aliaj  
Genti Manelli  
**Website:** Suela Gera  
Indrit Maraku

**Departamenti i Marketingut:**  
Cel: +355696060419  
marketing@shqiptarja.com

**Shpërndarja:**  
Saimir Zenelaj  
cel: +355696060418  
Ermal Kacaniku  
cel: +355696088847